




shqip



# ICF

## UDHËRRËFYES PËR KNF

### Kodi Ndërkombëtar i FunkSIONIMIT me gjuhë të kuptueshme për familjen

Zemrijet Bela Veseli, Manfred Pretis



Funksionet  
trupore



Strukturat  
trupore



pjesëmarrje



rrethina

With the support of the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union



Ky projekt është finansuar dhe përkrahur nga Komisioni Evropian. Ky botim reflekton vetëm qëndrimet e autorëve prandaj Komisioni nuk të mbahet përgjegjës për çfarëdo përdorimi të informatave këtij publikimi.

Edicioni 1, 1.7.2020

Publikues: Shoqata Qytetare për ngritje e vetëdijes  
psiko - sociale "IMAGO PLUS", Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

ISBN: 978-608-66254-2-9



**Produkt i kualitetit të lartë 2 në kuadër të projektit  
„gjuhë të përbashkët në shkollë“ nga programi i Erasmus+**

[www.icf-school.eu](http://www.icf-school.eu)

**Autorët:**

**Zemrijet Bela - Veseli** është magjistre e psikologjisë klinike pranë Fakultetit Inaternalional Balkanik në Shkup. Ajo punon për 15 vite psikologe në shkollë, poashtu bën trajtimin e fëmijëve me pengesa në zhvillim në moshën e herëshme.

Ajo është Kryetare e OJQ IMAGO PLUS

**Manfred Pretis** është profesor në Shkollën e Mjeksisë në Hamburg dhe Ndërrmarje e vogël dhe e mesme ( NVM) private i cili meret me hulumtime dhe trajnime në fushën e personave me pengesë në zhvillim posaçërisht me fëmijët. Ai është kontraktuesi dhe koordinatori kryesor i projektit dhe pjesë e Bordit Këshillues të OBSH-së, në konceptin “ Kujdesi ushqyes” të OBSH-së / UNICEF -it.

**Ko-Autorë:**

Aleksandra Dimova

Evdokija Koceva

Vilma Niçeva

**Publikues:** Shoqata Qytetare për ngritje e vetëdijes psiko - sociale "IMAGO PLUS"  
rr: Vasil Çakalarov no:4 Çair, 1000 Shkup  
Republika e Maqedonisë së Veriut

[contact@educationforall.org.mk](mailto:contact@educationforall.org.mk)

[www.educationforall.org.mk](http://www.educationforall.org.mk)

**Dizajni:** Michael Eisner

Licencë e hapur: attribution 4.0 International (CC BY 4.0)

<https://creativecommons.org/licences/by4.0/legalcode>

Impresum	3
ParaKontratë	5
1. Verzioni i KNF-së në gjuhë të kuptueshme për familjen: hyrje	6
1.1 Çka është KNF-ja?	6
1.2 Si punon KNF-ja?	7
1.3 Çfarë ne bëjmë kur përdorim KNF-në	10
1.4 Vlerësim i përbashkët	17
1.5 Ne caktojmë qëllime të përbashkëta	20
1.6 Konstatim	21
2. Lista e përgjithshme e kodeve nga verzioni i KNF-së në gjuhë të kuptueshme për familjen	22
2.1 FUNKSIONET TRUPORE	23
2.2 PJESËMARRJA	47
2.3 RRETHINA (RRETHI)	73
3. Literatura	92
4. Projekti dhe partneri	93



Në këtë broshurë bëhet fjalë për mbështetjen e fëmiut tuaj. Me ndihmën e kësaj broshure, Ju si prindër mundeni bashkë me ekspertët të flisni për përkrahjen që ka nevojë fëmiu juaj. Duke shfrytëzuar broshurën, Ju si prindër bashkë me ekspertët do të flisni me gjuhë të përbashkët. Kjo broshurë ndahet në dy pjesë:

- I. **Hyrje në verzionin e KNF-së me gjuhë të kuptueshme për familjen dhe**
- II. **Lista e përgjithshme e kodeve nga versioni i KNF-së me gjuhë të kuptueshme për familjen**

### 1.KNF për prindërit: Hyrje

Për ne ekspertët, është shumë me rëndësi që prindërit të kuptojnë çfarë themi. Si ekspertë që jemi, ne e shfrytëzojmë KNF - në. Është një ndihmesë e madhe dhe nëse ju si prindër e përdorni, atëherë do të mund të merremi vesh më mirë rreth asaj se çfarë ndihme i duhet fëmiut tuaj.

Për atë arsye ne e përpilojmë këtë tekst në një gjuhë më të lehtë dhe të kuptueshme. Të gjithë prindërit do të mund ta kuptojnë tekstin e përpiluar. Në këtë tekst, ne japim shumë shembuj. Shembujt janë vendosur në sipërfaqen me ngjyrë të kaltërt.

## 1.1 Çka është KNF?

Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, pengimit dhe shëndetit është mjet që ndihmon. **Shkurtimisht e shkruajmë KNF.** Këtë mjet, ju mund ta shfrytëzoni me ekspertët tuaj. Ky mjet mund t'ju ndihmojë juve së bashku me ekspertët që të planifikoni terapinë e fëmiut tuaj i cili ka problem.

**Është e rëndësishme** për ju si prindër të shfrytëzoni këtë mjet sepse do t'ju ndihmojë të kuptoheni me ekspertët. Ju do të mund ti rrëfeni brengat e juaja dhe të jepni propozime. Dhe kështu ju do t'i ndihmoni fëmiut tuaj. KNF - ja është mjet për të përshkruar. Ky mjet është përpiluar nga Organizata Shëndetësore Botërore. Organizata botërore merret me shëndetin. Mjet tjetër i njohur është Klasifikimi Botëror i Sëmundjeve (KNS -10). KNS i përshkruan diagnozat dhe sëmundjet e fëmiut. Për dallim të KNF - së, KNS-ja nuk përshkruan diagnoza por KNF - ja përshkruan detalisht se çfarë ndihme dhe çfarë terapie i duhet fëmiut tuaj.

**Është shumë e rëndësishme** që ju si prindër të jeni pjesë e ekipit rreth familjes suaj. KNF - ja u ndihmon rreth bisedës me mjekët, fizioterapeutët, logopedët, pedagogët, dhe mësuesit. KNF - ja u ndihmon të shpjegoni çfarë është e rëndësishme për ju kur ju doni t'i ndihmoni fëmiut tuaj.

**Është shumë e rëndësishme** se ju, si prindër, jeni të rëndësishëm për fëmiun tuaj. Fëmiu juaj është i lidhur me ju. Ju e njihni më së miri fëmiun tuaj. Është gjithashtu e rëndësishme që ju t'u thoni ekspertëve se si t'i ndihmohet fëmiut tuaj. Është me rëndësi që ju t'i kuptoni të gjitha informacionet që ua thonë ekspertët. Së bashku me ekspertët ju do t'i siguron fëmiut tuaj ndihmën më të mirë.

Ekspertët gjithashtu e përdorin KNF-në.

KNF - ja u ndihmon dhe u bën partner i barabartë me ekspertët. Ekspertët u dëgjojnë dhe së bashku i ndihmoni fëmiut tuaj.

## 1.2 Si funksionon KNF - ja?

KNF - ja u ofron shumë mundësi. KNF - ja përshkruan se çfarë mund të bën fëmiju juaj. Gjithashtu, KNF -ja përshkruan cilat janë vështirësitë tek fëmiju i juaj.

KNF - ja përshkruan:

- a) **karakterin personal** të fëmiut tuaj,
- b) rrethin më të ngushtë të fëmiut tuaj: shtëpinë e tij, Kopshtin, Shkollën, Qendrën Ditore ose diçka tjetër.
- c) KNF - ja e përshkruan trupin e fëmiut tuaj, p.sh:
  - Sa është i gjatë fëmiju,
  - Sa peshon fëmiju,
  - A i punon mirë zemra,
  - A i punojnë mirë mushkëritë.
- ç) KNF - ja gjithashtu përshkruan edhe :
  - A dëgjon mirë fëmiju,
  - A shikon mirë fëmiju,
  - A merr frymë si duhet,
  - Si lëviz fëmiju.

Këto quhen **funksione trupore**.

Në KNF është shumë me rëndësi edhe çfarë bën fëmiju juaj gjatë ditës. Për shembull: a luan fëmiju juaj si fëmijët tjerë? A flet me fëmijët tjerë? A shkon me autobus në shkollë? A di të lexojë dhe shkruaj? Dhe a ka shokë fëmiju juaj? E gjithë kjo quhet **pjesëmarrje**. Përkrahja e shkollës i ndihmon fëmiut të bëjë atë që bëjnë edhe fëmijët tjerë, sa më mirë.

**Shembull:** Çfarë bën gjatë ditës një fëmijë 2 vjeçarë?

Një fëmijë 2 vjeçarë vrapon.

Një fëmijë 2 vjeçarë ushqehet vetëm me lugë. Nganjëherë ushqehet edhe me gishtat e tij.

Një fëmijë 2 vjeçarë pi nga gota.

Fëmiu i vështron librat.

Fëmiu ka dëshirë të dëgjojë përralla.

Luan me lodra.

Imiton nënën dhe babain.

Shpesh, një fëmijë 2 vjeçarë flet disa fjalë.

Ai tregon me dorë atë që dëshiron ta merr.

Një fëmijë 2 vjeçarë i vështron fëmijët e tjerë. Luan afër tyre.

*Kjo paraqet shembull për pjesëmarrje të fëmiut 2 vjeçar.*

Çfarë bën një fëmijë 5 vjeçarë gjatë ditës?

Një fëmijë 5 vjeçarë shkon në kopsht.

Luan bashkë me shokët e tij.

Një fëmijë 5 vjeçar ha dhe pi vetë.

Një fëmijë 5 vjeçar shkon në banjo.

Di vetëm të zhvesh dhe vesh pantallonat.

Fëmiu 5 vjeçar di të vizatojë lule, shtëpi apo veten.

Di të kryejë detyra të vogla, kompletton mozaikun.

Një fëmijë 5 vjeçarë e kupton gjuhën. Thurr disa fjali.

Kjo paraqet shembull për **pjesëmarrje** të fëmiut 5 vjeçar.



Çfarë bën një fëmijë 8 vjeçarë gjatë ditës?

Një fëmijë 8 vjeçar mëson si të lexojë dhe shkruajë.

Fëmiju 8 vjeçar shkon vetëm në shkollë me autobus.

Ec nëpër klasë dhe gjatë pushimit pa ndihmën e askujt.

Fëmiju 8 vjeçar ha shujtën e tij pa ndihmën e askujt.

Fëmiju 8 vjeçar flet me fëmijët e tjerë dhe me arsimtarët.

Fëmiju 8 vjeçar përcjell mësimet e lëndëve.

Fëmiju 8 vjeçar kujdeset dhe fokusohet në mësimet.

Kjo paraqet shembull për pjesëmarrje të fëmijut 8 vjeçar.

Këta ishin 3 shembujt e pjesëmarrjes. Janë vetëm shembuj. Këta shembuj mund të përshkruhen edhe më detalisht. Ata janë për të shpjeguar se çfarë nënkupton KNF-ja. Në bazë të KNF-së pjesëmarrja është shumë e rëndësishme.

**Është me rëndësi** të dini se pjesëmarrja mund të jetë e vështirë për fëmijët me pengesa në zhvillim. Si p.sh:

- Nëse fëmiju dëgjon dobët, mund të flasë me vështirësi.
- Nëse fëmiju shikon dobët, më vështirë qarkullon nëpër klasë. Mund që fëmiju të hasë në vështirësi edhe të leximit edhe të shkrimit. Me siguri këtu mund të ndihmojë edhe përdorimi i alfabetit Brajov.

Përkrahja dhe terapia i ndihmon fëmijëve me pengesa në zhvillim. Përkrahja e fëmijut tuaj në shkollë ka domethënie të madhe sepse ai duhet të zhvillohet si fëmijët e tjerë. KNF-ja nuk u tregon se çfarë u mungon fëmijëve tuaj.

Shpesh, mjekët gjatë kontrollimeve gjejnë se çfarë i mungon fëmijut tuaj. Ajo quhet diagnostifikim. Pasi që të diagnostifikohet, ekspertët bashkë me ju kërkojnë ndihmë për fëmijun tuaj. **Kjo pjesë është shumë e rëndësishme për ju si prindër.** KNF-ja nuk jep dijagnozë. KNF-ja përshkruan çka mund të bën fëmiju juaj. KNF-ja gjithashtu përshkruan se çfarë ndihme i duhet fëmijut tuaj.

KNF-ja mund të praktikohet tek secili fëmijë, jo vetëm tek ata që kanë pengesa në zhvillim.

### 1.3 Çfarë veprojmë Ne kur përdorim KNF-në?

Ne mbikëqyrim fëmiun tuaj, bashkë me ju (prindër). Ne, bashkë me ju, vështrojmë këto gjëra:

Fëmiu im luan i vetëm në ndërtesë.

Fëmiu im vrapon rrotull dhe merr frymë shpejt.

Fëmiu im vritet në cep të tavolinës.

Fëmiu im flet maqedonisht dhe turqisht.

Fëmiu im tenton të merr lodrën me dorën e djathtë.

Fëmiu im luan në shtëpi, duke u shtirur se po ngulfatet.

Fëmiu im është vajzë 9 vjeçare.

Ju po lexoni nga libri, fëmiu juaj u dëgjon se si ju lexoni.

Fëmiu im ka interes për dinosaurët.

Fëmiu im është shkurtpamës.

Fëmiu im ka nevojë për syze.

Fëmiu im (vajzë) ka 3 vëllezër dhe motra.

Vajza ime është në klasë të tretë.

Arsimtari e lavdëron vajzën time.



Pastaj e përdorim terminologjinë e KNF-së. P.sh: fillimisht monitorojmë, më pastaj përshkruajmë se çfarë mund të bëj fëmiju juaj. Më tej, e emërtojmë me terminologjinë e KNF-së. Kjo terminologji e KNF-së është diçka e re për ju. Ekspertët e përdorin këtë terminologji. Nëse edhe ju e njihni këtë terminologji atëherë është më e lehtë të flisni me ekspertët.

Një pjesë e kësaj terminologjie përdoret për ta përshkruar fëmijun tuaj dhe e quajmë **strukturat trupore**. Pra, një pjesë e kësaj terminologjie përdoret për të përshkruar fëmijun tuaj; se si fëmiju juaj merr frymë, e tret ushqimin, sa e ka shtypjen e gjakut, a shikon mirë dhe a dëgjon mirë. Këto i quajmë **funksione trupore**.

Më tej, një pjesë të kësaj terminologjie e përdorim për të përshkruar fëmijun tuaj se çfarë bën ai. Këtë e quajmë **pjesëmarrje**. Një pjesë të kësaj terminologjie e përdorim për të përshkruar karakteristikat personale të fëmijut tuaj. Për shembull, me çka dallohet (veçohet) fëmiju juaj nga fëmijët e tjerë ose çfarë karakteristika ka fëmiju juaj. Këto i quajmë **faktorë individual**.

Dhe në fund përshkruajmë rrethin më të rëndësishëm të fëmijut tuaj. Ajo varet nga:

Kush e ruan fëmijun tuaj?

Sa motra dhe vëllezër ka fëmiju juaj?

A ka fëmiju juaj lodra në shtëpi?

A ka nevojë fëmiju juaj për syze dhe medikamente?

A e ka shkollën afër fëmiju juaj?

A ka autobus shkollor fëmiju juaj?

Kush është krenar me fëmijun tuaj?

E tëra kjo quhet **rrethinë** ose **ambient jetësor** i fëmijut tuaj.

Në fund, na mungon një pjesë e cila ndërlidhet me pyetjet vijuese: Për çfarë brengoseni ju? Çfarë thot mjeku? A ka diagnozë? Kjo quhet **kujdesi për fëmiun** apo **shëndeti** i fëmiut tuaj .

Tanimë kemi 6 terme: strukturat trupore, funksionet trupore, pjesëmarrje, faktorë individual, rrethinë dhe kujdesi për shëndetin apo gjendja shëndetësore. Me këto terme ne përshkruajmë fëmiun tuaj. Pastaj, së bashku përpilojmë një plan se si t'i ndihmohet fëmiut tuaj dhe të kujdesemi për të.

Ky vëzhgim dhe përshkrimi nga terminologjia e KNF-së ndihmon në qartësim duke shfrytëzuar shembujt e sipër-përmendur.


Vëzhgim	Terminologjia e KNF-së
Fëmiu im luan i vetëm në ndërtesë.	<b>Pjesëmarrje</b> (është shumë e rëndësishme që fëmiu im të luaj sepse ai mund të mëson gjëra të tjera përmes lojës).
Fëmiu im vrapon rrotull dhe merr frymë shpejt.	Frymëmarrjen e quajmë <b>funksion trupor</b> . Frymëmarrja na ndihmon për të jetuar.
Fëmiu im lëndohet në cep të tavolinës.	Dhembjen gjatë lëndimit e quajmë funksion trupor. Dhembja është e nevojshme sepse na paralajmëron se diçka nuk është në rregull.
Fëmiu im flet gjuhën shqipe, maqedonase dhe turke.	Njohja e dy gjuhëve është diçka e veçantë. Shumë pak fëmijë jetojnë nëpër familje ku fliten dy gjuhë. Njohja e dy gjuhëve është diçka <b>personale</b> dhe <b>individuale</b> .
Fëmiu im mundohet të merr lodrën me dorën e tij të djathtë.	Këtë e quajmë <b>pjesëmarrje</b> . Fëmiu juaj mundohet të marrë lodrën e tij dhe të bën diçka me të.

Fëmiu im luan i vetëm në shtëpi dhe shtiret se ngulfatet.	Këtë e quajmë pjesëmarrje. Me siguri fëmiu juaj ju imiton prandaj edhe mëson gjëra të reja.
Fëmiu im është vajzë 9 vjeçare.	Kjo quhet diçka <b>personale</b> apo <b>individuale</b> .
Ju lexoni nga mozaiku. Fëmiu juaj ju dëgjon se si ju lexoni.	Ky shembull përbëhet prej dy pjesëve: Fëmiu juaj mund të dëgjon, dhe quhet funksion trupor. Pjesa e dytë: fëmiu i juaj dëgjon dhe përmes dëgjimit mëson fjalë, emra dhe përralla. Këtë e quajmë <b>pjesëmarrje</b> .
Fëmiu im ka interes për dinosaurë.	Kjo gjithashtu është diçka personale ose <b>individuale</b> . Ky interes individual e bën fëmiun tuaj më ndryshe nga fëmijët tjerë.
Fëmiu im është shkurtpamës.	Me siguri fëmiu i juaj e ka retinën e syrit të madhe. Këtë e quajmë <b>strukturë trupore</b> .
Fëmiu im ka nevojë për syze.	Ky shembull prapë ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë: ndoshta <b>struktura</b> e syrit të fëmiut tuaj është më ndryshe se e fëmijëve tjerë. A mund fëmiu juaj të merr syze, varet edhe nga rrethi ku ai jeton: p.sh në rrethin tuaj, a ka mjek që mund t'i përshkruaj syze fëmiut tuaj. A keni ju para të mjaftueshme për t'i blerë syze atij. Kjo i përket <b>rrethit</b> të fëmiut tuaj.
Fëmiu im ka 3 vëllezër dhe motra.	Kjo gjithashtu i përket rrethit. Çfarë njerëz jetojnë me fëmiun tim.

Vajza ime është në klasën e tretë.	Ky shembull ndahet në dy pjesë: ekziston shkollë afër shtëpisë suaj dhe kjo i përket rrethit. Vajza ime shkon në shkollë dhe mëson në shkollë bashkë me fëmijët e tjerë. Këtë e quajmë <b>pjesëmarrje</b> .
Mësuesja e lavdëron vajzën time.	Kjo i përket rrethit. Më saktë, kjo i përket qëndrimit ose sjelljes të mësueses ndaj vajzës sime.

Këto 6 fusha ose terme: struktura trupore, funksione trupore, pjesëmarrje, faktorë individual, rrethinë dhe kujdesi për shëndetin apo gjendja shëndetësore e fëmijut tuaj i quajmë 6-ja e madhe e KNF-së. Këto fusha apo terme janë të ndërlidhura mes vete. Me ndihmën e 6-shes së madhe mund të hetojmë dhe të kuptojmë se për çfarë përkrahje ka nevojë fëmiju i juaj në shkollë.

Kur ne e përshkruajmë fëmijun tuaj nuk është me rëndësi se nga cila fushë apo term nga 6-ja e madhe do t'ia nisim sepse të gjitha fushat e 6-shes së madhe janë të ndërlidhura.



Ilustrim 1. "6-ja e Madhe" e KNF-së.

Eksperti u tregon juve që fëmiju juaj është me pengesa në zhvillim. Se çfarë dëshiron t'u thotë eksperti kur thotë se fëmiju ka vështirësi në shkollë dhe si duket 6-ja e Madhe e KNF-së për fëmijën tuaj. Për ju si prindër, ndoshta është e vështirë kur gjatë bisedimit me ekspertët përmendet fjala vështirësi apo pengesa në zhvillim. Asnjë prindër nuk dëshiron një fëmijë me të meta apo me pengesa në zhvillim.

Për atë arsye, duhet të vlerësohet se çfarë ndikimi ka rrethi mbi fëmijën tuaj. Nganjëherë fëmiju nuk është vetëm me pengesa në zhvillim. Nganjëherë rrethi ndikon shumë në pengesat. Rrethi, gjithashtu mund të rezultojë si pengesë në zhvillimin e fëmijës. Ja si mund të ndodhë:

Nuk ka syze të disponueshme për fëmijën tuaj shkurtpamës. Sepse rrethi i pengon atij të marrë syzet e nevojshme.

Nuk ekziston autobus shkollorë madje asnjë shkollë e duhur në afërsi të shtëpisë suaj. Këtu rrethi i pengon fëmijën tuaj të zhvillohet dhe të përparojë si duhet.

Shkolla ka vështirësi ta pranojë dhe të adaptohet sipas kërkesave të fëmijës me pengesa në zhvillim. Këtu rrethi i pengon fëmijën të zhvillohet dhe të përparojë si duhet.

Në shkollë, nuk ka kalime përkatëse për lëvizjen e fëmijës me karrocë invaliditeti. Këtu rrethi i pengon atij të lëviz lirshëm dhe në mbarëvajtjen shkollorë.

Fëmijët gjithashtu kanë shumë anë të fuqishme apo aftësi. Prandaj është e rëndësishme të përshkruhet se çfarëmund të bëjë fëmiju i juaj. Secili nga ne dëshiron të jetë krenar me fëmijën e vet.

Por, edhe diagnostifikimi është shumë i rëndësishëm. Mendimi i mjekëve është i rëndësishëm. Nganjëherë mjekët e mjekojnë fëmijën tuaj por nuk i përshkruajnë medikamente.

Përkrahja e fëmijës tuaj në shkollë është qëllim shumë i rëndësishëm. Qëllimi është që të arrihet ajo pikë, kur fëmijës tuaj s'do t'i duhet më ndihmë në shkollë. Këtë e quajmë prevenim ose ndalim. Sa më herët të fillohet me përkrahjen e fëmijës tuaj, aq më të mëdha janë mundësitë për të ndaluar pengesat në zhvillim të fëmijës tuaj si dhe t'i mundësohen kushte më të mira për zhvillim.



## 1.4 Vlerësim i përbashkët

Ekspertët dhe prindërit së bashku e përdorin KNF-në. Ekspertët dhe prindërit vetëm atëherë mund të flasin me gjuhë të përbashkët dhe të kuptohen. P.sh. disa fëmijë kanë pengesa në shkollë.

Kur themi se fëmiju ka pengesa në shkollë, me atë duam të themi se fëmiju ka sjellje më ndryshe nga fëmijët e tjerë. Mund të egzistojnë shumë shkaqe për këtë sjellje:

Fëmiju shkruan më ngadalë se fëmijët e tjerë.

Fëmiju vrapon në shkollë më shumë se fëmijët e tjerë gjatë kohës së mësimin.

Fëmiju kalkulon më ngadalë se fëmijët e tjerë.

Fëmiju s'mund të degjojë mirë atë që mësuesja e shpjegon.

Fëmiju s'mund të shoh mirë atë që mësuesja e shkruan.

Fëmiju lëviz me karrocë invaliditeti dhe ka nevojë për ndihmë. Për këtë arsye me vështirësi vjen në shkollë.

Fëmiju interesohet dhe merret vetëm me një lëndë.

Disa fëmijë kanë nevojë për ndihmë në shkollë. Duhet të vlerësojmë se çfarë dhe cilat janë vështirësitë e mëdha të fëmijut në mënyrë që fëmiju të marrë përkrahjen e duhur në shkollë. Ky vlerësim duhet të bëhet duke u përgjigjur në disa pyetje vijuese: Sa i madh është problemi sipas prindërve? Sa i madh është problemi sipas fëmijut? Sa i madh është problemi sipas shkollës? Kur të vlerësojmë problemin që ka fëmiju, gjithmonë e krahasojmë fëmijun me moshatarët e tij të cilët nuk kanë problem shëndetësor ose vështirësi shëndetësore.

Fëmijut tim i cili është në klasën e dytë, i duhen disa sekonda për të lexuar tërë fjalinë. Fëmiju im lexon shkronjë për shkronjë. Shumë fëmijë të tjerë, moshatarë të fëmijut tim, mund të lexojnë tërë fjalinë. Fëmiju im ka problem në shkollë. Fëmiju im lexon ngadalë. Ky lexim i ngadalshëm paraqet problem për mësuesen dhe për mësimin e materialit mësimor.

Ne, së bashku, bëjmë vlerësimin. Ne vlerësojmë se sa i madh është problemi i fëmijut. Pastaj së bashku vendosim çfarë të bëjmë dhe si t'i ndihmojmë atij.

Është shumë me rëndësi që problemin ta vlerësojmë së bashku, sikur një "ekip përreth familjes". Mësuesit na dëgjojnë ne, pastaj së bashku sjellim vendim.

Nganjëherë, është e rëndë të bëjmë vlerësim së bashku. Nganjëherë ne kemi mendim ndryshe nga ju, por ajo s'na pengon. Nganjëherë duhet dhënë më shumë kohë. Është e nevojshme që fëmiun ta vështrojmë më gjatë. Pastaj mund përsëri të bisedojmë me ekipin dhe më pastaj ta vlerësojmë problemin.

Ne përdorim mjete ndihmëse kur bëjmë vlerësimin së bashku. Për shembull, përdorim numra, të cilët dallohen nga vlerësimet shkollore.

Kur në vlerësim vendosim 0 (zero) atëherë themi se s'ka problem.

Ne, si ekspertë, jemi të kënaqur kur fëmiu nuk ka problem në ndonjë nga mësimet e tij shkollore. Për ju si prindër është shumë me rëndësi të njihni që fëmiu i juaj nuk ka asnjëlloj problemi me mësimin.

Por, gjithashtu ka lëndë mësimore ku ai mund të ketë problem. Atëherë i shfrytëzojmë numrat vijues:

- .1 = „Problem i lehtë“
- .2 = „problem mesatar“
- .3 = „problem me rëndësi“
- .4 = „problem i kompletuar“
- .8 = dmth, ne nuk jemi pajtuar me problemin, por akoma nuk dihet.

Problemi varet edhe nga mosha e fëmiut tuaj. Për shembull:

	Problemi	Rrethi
Fëmiut 4 vjeçar akoma i duhen pelenat gjatë natës.	Ajo nuk paraqet problem (=0). Shumë fëmijë mësohen gjatë kësaj moshe.	
Vajza 6 vjeçare vizaton vetëm viza dhe rrathë.	Kjo mund të paraqet problem. Kjo mund të nënkupton se fëmiu e ka të vështirë të shkruan në shkollë. Kjo nganjëherë mund të nënkupton edhe problem shumë i madh. (.3).	Kjo gjithashtu varet edhe nga sjellja e mësueses. A i jep mësuesja kohë të mjaftueshme vajzës në orë mësimi? A di mësuesja ushtrime të cilat fëmiu mund t'i praktikon?
Një djalë nuk flet aspak kur është në shkollë. Mirëpo, ai flet me prindërit e tij dhe vëllezërit e motrat në shtëpi.	Kjo mund të jetë problem si për shkollën ashtu edhe për profesionin që djali do ta përzgjedh më vonë. Sepse djali nuk flet dhe njerëzit përreth nuk e dinë a kupton ai. Ky mund të jetë problem serioz. (.3).	Ky problem varet edhe nga sjellja e prindërve të fëmiut. A ushtrojnë presion mbi djalin? A kanë kërkuar ndihmë për djalin nga ekspertët?

Kur bëjmë vlerësim, është shumë e rëndësishme të mos harrohet: Rrethi ka shumë ndikim. Ne gjithashtu bëjmë vlerësim edhe si është rrethi. Rrethi mund të stimulon ose të inkurajon zhvillimin e fëmiut ose të pengon zhvillimin e tij.

## 1.5 Ne caktojme qëllime të përbashkëta

Ekspertët dhe ju si prindër jeni të pajtimit se fëmijët tuaj i duhet ndihmë. KNF-ja ndihmon të kuptojmë se në cilat fusha i duhet ndihma fëmijët tuaj. Mirëpo ndihma u duhet edhe fëmijëve të tjerë. Jo TË GJITHË fëmijët kanë nevojë për ndihmë. Por çdo fëmijë duhet ndihmuar.

Çfarë mbikëqyrim?	Si e bëjmë vlerësimin?	Për çfarë bëhet fjalë?	Si është rrethi?	Për çfarë ndihme ka nevojë fëmijë ynë?
Fëmijë ynë ka 10 vjet dhe akoma lexon shkronjë për shkronjë.	Kjo paraqet problem serioz(.3). fëmijët e tjerë lexojnë tërë fjalën dhe fjalitë.	Bëhet fjalë për <b>mësim</b> .	Ne mund t'i ndihmojmë në shtëpi. (e+).	Fëmijët tonë i duhet ndihma për të lexuar.
Vajza jonë (7 vjeçare) luan në shkollë vetëm me kukullat e saj.	Kjo paraqet problem mesatar(.2).	Bëhet fjalë për mësim.	Ne nuk kemi shumë kohë për t'i ndihmuar asaj sepse e ruajmë gjyshen e saj.	Vajza jonë ka nevojë të kalojë më shumë kohë në shkollë. Ne do të presim se si do të zhvillohen-gjërat.
Djali ynë (8vjeçar) vrapon rrotull shkollës. Ai i shtyen fëmijët e tjerë.	Kjo paraqet problem serioz (.3).	Bëhet fjalë për atë se si të silllet dhe të qëndrojmë fëmijët e tjerë.	Nganjëherë në shtëpi fjalosemi shumë rreth asaj.	Duhet të zbulojmë dhe të kuptojmë se çfarë po ndodh me fëmijën tonë. Do të vizitojmë mjekun.

Kur të caktojme qëllime, shpesh mjafton 3 ose 4 qëllime që fëmiu duhet t'i arrijë brenda një viti shkollorë.

Është shumë me rëndësi që prindërit t'i kuptojnë këto qëllime. Ekspertët punojnë së bashku me prindërit dhe së bashku i caktojnë qëllimet. Por, çfarë është një qëllim? Është ajo që duhet të arrijë fëmiu juaj për një afat të caktuar. Çfarë dëshiron për fëmiun tuaj të arrijë? P.sh:

Deri në fund të vitit shkollor Petriti duhet të mësojë të bëj dallimin mes 4 shkronjave.

Sara duhet vetë të llogarisë numrat në detyrat e shtëpisë deri në fund të vitit shkollor.

Jetoni duhet të mësojë ta gjejë vetë klasën e tij ose sallën sportive deri në fund të vitit shkollor.

Një qëllim i caktuar mund të arrihet përmes planifikimit të hapave të vegjël.

## 1.6 Përmbledhje

Me ndihmën e KNF-së shumë më mirë mund të vlerësohet zhvillimi i fëmiut. Me ndihmën e KNF-së mund të shihet dhe të potencohet se në cilën fushë dhe në cilën mënyrë duhet t'i ndihmohet fëmiut. KNF-ja është një mjet ndihmues. Ky mjet u mundëson anëtarëve të ekipit të flasin së bashku për të njëjtën temë sepse me ndihmën e KNF-së çdo anëtar di se për çfarë bëhet fjalë dhe di se çfarë duhet ndërmarrë.



## 2. Lista e plotë e kodeve nga verzioni i KNF-së në gjuhë më të kuptueshme për familjet

Në pjesën e dytë të kësaj broshure janë vendosur të gjitha termet dhe fjalët për të ndihmuar përshkrimin e fëmijut tuaj. Ato janë të vendosura në të njëjtin rend sikur në verzionin origjinal të KNF-së, e cila është e publikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Së pari janë vendosur funksionet trupore, pastaj është përshkruar pjesëmarrja dhe në fund është vendosur rrethi.

Këto pjesë kanë akronime ose shkurtesa. Shkurtesat janë nga gjuha angleze:


- Me „b“ janë caktuar **funksionet trupore** (angl, body functions)
- Me „d“ është caktuar **pjesëmarrja** (angl. Domains)
- Me „e“ është caktuar rrethi (angl. Environment)




Tek disa vende të funksionet trupore do të vëreni edhe shkurtesën „s“. Me „s“ janë caktuar **strukturat trupore**.

Do të vëreni se afër shkurtesave qëndrojnë NUMRAT. Ekspertët i shfrytëzojnë numrat. P.sh. „d880“ do të thotë se bëhet fjalë për LOJË. Këto numra janë shumë të rëndësishëm për ekspertët dhe për sigurimin shëndetësor për të përmirësuar dhe për të marrë terapi adekuate. Për ju si prindër, këta numra nuk janë të rëndësishëm.

Për informata më të hollësishme mund të vizitoni edhe web faqen e projektit tonë: [www.icf-school.eu](http://www.icf-school.eu). Atje ju mund të lexoni më shumë informata ose më lehtë mund të gjeni termet (terminologjitë) dhe fjalitë që ju duhen.





<b>b</b> 	<b>Funksionet trupore</b> <p>Vështirësit në drejtim të vonësës së zhvillimit mund të paraqiten gjatë fëmërisë dhe adoleshencës. Këto vështirësi mund të shfaqen në shumë fusha. Në pjesën b i përshkruajmë këto mënyra individuale të funksionimit të trupit tonë. Ato i quajmë funksione trupore.</p>
<b>s</b> 	<b>Strukturat trupore të fëmiut tim</b>
<b>b1</b> 	<b>Funksionet mendore</b> <p>Kjo pjesë tregon se si funksionon truri ynë. Funksionet e tij ndahen në: 1. funksione globale (të përgjithshme) dhe 2. funksione specifike (mentale ose mendore). Funksionet e përgjithshme përshkruajnë vetëdijen, energjinë psikike (shpirtërore) dhe sulmet (impulset / instinktët). Funksionet specifike përfshijnë mënyrën e kujtesës, vëmendjes, emocioneve, perceptimin, aftësitë matematikore, vetë-orientimin dhe orientimin kohor, si dhe aftësinë për të kuptuar ato që janë thënë.</p>
<b>s1</b>	<b>Strukturat nervore të fëmiut tim</b>
<b>b110</b>	<b>Vigjilencë dhe vëzhgim i vetëdijshëm i mjedisit</b> <p>Fëmiju im është i zgjuar. Mund të perceptojë me vetëdije mjedisin që e rrethon. Mirëpo problemet mund të shfaqen në rastet e sulmeve epileptike ose temperaturës.</p>
<b>s110</b>	<b>Strukturat e trurit të fëmiut tim</b>



**b114****Orientimi/ndërgjegjsimi**

Fëmija im e njih veten e tij: ai e di emrin e tij dhe si janë njerëzit e tjerë. Ai i di emrat e objekteve. Ai përqendrohet në rrethin e tij. Është i vetëdijshëm për kohën dhe hapësirën (për shembull, ai kupton se çfarë kuptimi kanë fjalët "sot", "nesër", "dje", etj.).

**b117****Sjellje e arsyeshme**

Fëmija im e kupton botën në të cilën jeton dhe silllet në mënyrë të arsyeshme. Kjo varet nga mosha e tij. Fëmija im kupton marrëdhëniet shkak-pasojë midis fjalëve "kur-atëherë". Fëmija im ka idetë e tij dhe mund të zgjidhë problemet e përditshme.

**b122****Realizim i kontakteve dhe mardhënieve me të tjerët**

Fëmija im mund të krijojë kontakte dhe të lidhet me njerëz të tjerë. Ai vazhdimisht po i zhvillon këto aftësi.

**b125****Mund të përshtatet/mund të qetësohet**

Fëmija im mund të përshtatet me diçka të re. Mund, për shembull, të qetësohet. Mund të përqendrohet në një gjë. Kjo aftësi mund të jetë më vonë baza për temperamentin dhe tiparet e personalitetit të tij.

**b126****Ai zhvillon stilin e tij dhe personalitetin e tij**

Fëmija im po zhvillon personalitetin e tij. A është fëmija im i hapur apo i pasigurt dhe i tërhequr? A është i ndërgjegjshëm? E sheh të ardhmen e tij me optimizëm dhe besim? E gjithë kjo është pjesë e kësaj.

**b130****Ka dëshirë dhe motivim (impuls) për diçka**

Fëmija im ka dëshirë për të bërë diçka. Mund ti plotësojë nevojat e tij dhe ti përmbushë dëshirat dhe qëllimet tij.

**b134****Gjumi**

Kur fle, fëmija im nuk është në kontakt me rrethinën e tij. Pasi fle, fëmija im është përsëri zgjuar. Gjendja e gatishmërisë dhe gjendja e gjumit ndryshojnë rregullisht tek fëmija im. Kur fëmija im fle, sytë e tij janë të mbyllur. Fëmija im mund të ëndërrojë ndërsa fle.

**b140****Vëmendja**

Fëmija im mund të përqendrohet, të koncentrohet në diçka dhe të bëjë diçka për një periudhë të caktuar kohore. Duke vepruar kështu, nuk lejon që ai të shpërqendrohet.

**s140****Strukturat nga pjesa e simpatikusit në sistemin nervor vegjetativ****b144****Kujtesa/mbamendje**

Fëmija im mund të mbajë mend disa gjëra dhe më vonë t'i kujtojë ato. Për shembull, gjatë mësimit, mund të kujtohet për diçka (për ndonjë pushim, për shembull).

**b147****Menaxhon sjelljen e tij**

Fëmija im mund të menaxhojë sjelljen e tij. Kjo mund të vlejë për veprime të shumëfishta: nëse ai përdor dorën e djathtë apo të majtë, me çfarë shpejtësie reagon, si është i organizuar veprimi i tij etj.

b152

**Menaxhon emocionet**

Fëmija im mund ti menaxhojë emocionet e tij në situata të ndryshme dhe të reagojë në përputhje me rrethanat. Është në gjendje të kontrollojë dhe rregullojë emocionet dhe të shprehë ndjenja të ndryshme (për shembull: trishtim, lumturi, dashuri, frikë, zemërim, urrejtje, tension, gëzim dhe kujdes).

s150

**Struktra nga pjesa parasimpatike të sistemit vegjetativ nervor të fëmiut tim.**

b156

**Vëzhgim (përceptim)**

Fëmija im mund të vëzhgojë, perceptojë dhe njohë stimuj të ndryshëm. Ai njih dhe kupton atë që sheh. Kjo vlen për shembull, për anëtarët e familjes që i sheh në albumin familjar. Fëmija im e kupton atë që dëgjon: për shembull, ai e di që atë po e thërrasin kur ai dëgjon emrin e tij.

b160

**Mendim (të menduarit)**

Fëmija im mund të mendohet për diçka. Mendimi i tij mund të ketë ose të mos ketë ndonjë qëllim të caktuar. Ai mund të fokusohet në ndonjë ide të tij.

b163

**Mendimi i thjeshtë (të menduarit) sjellja e konkluzioneve**

Fëmija im i di gjërat e thjeshta: ai e di, për shembull, si të veprojë kur bie shi jashtë (që të mos laget). Mund të nxjerrë përfundime të thjeshta.

**b164****Mendim më i ndërlikuar (të menduarit) / (planifikim organizimi dhe zgjidhja e problemeve)**

Fëmija im mund të planifikojë diçka. Ai mendon dhe merr vendime. Mund të zgjidhë idetë e tij dhe të organizojë kohën e tij. Ai mund të vlerësojë se cila sjellje do të ishte më e përshtatshme në situata të caktuara. Fëmija im është i kuptueshëm dhe mund të vlerësojë gjërat dhe situatat.

**b167****Të folurit**

Fëmija im mund të njohë, të kuptojë dhe të përdorë ato që janë thënë dhe shkruar në një gjuhë ose një formë tjetër (për shembull, gjuhën e shenjave). Në disa fëmijë, për shembull, me vështirësi në lexim dhe shkrim, ose në disa të rritur me sëmundje të caktuara (për shembull, si rezultat i një goditje në tru), të folurit mund të jetë e vështirë.

**b172****Llogaritja**

Fëmija im mund të kuptojë numrat dhe grupet. Është në gjendje të përdorë procese të llogaritjes së thjeshtë ose të komplikuar (mbledhje, zbritje, detyra tekstuale). Tek disa fëmijë me vështirësi në numërim, gjithashtu kjo mund të jetë e vështirë.

**b176****Realizon lëvizje komplekse**

Fëmija im mund të kryejë / realizojë lëvizje komplekse (për shembull, thurje). Ai i bën këto lëvizje të përshtatshme për qëllimin e tij dhe sipas rendit të duhur. Fëmija është në gjendje të kombinojë lëvizje të thjeshta në një veprim (për shembull, të nxjerrë çelësin nga çanta dhe ta vendos në zinxhir). Është në gjendje të përdorë shprehjet e fytyrës dhe gjuhën e trupit në mënyrën e duhur dhe të imitojë veprimet.

b180

**Përfaqëson për veten dhe për kohën**

Fëmija im e njeh për shembull emrin e tij dhe ka një ide për trupin e tij, duke përfshirë krahët, këmbët dhe kokën. Ai e di se ku është në situata të ndryshme, mjedise të ndryshme dhe është i vetëdijshëm për kohën.

b2 **Përdorimi i shqisave dhe ndjenja e dhimbjes**

Kjo pjesë trajton shqisat tona. Kjo vlen, për shembull, për të parë, dëgjuar, shijuar dhe ndjerë dhimbje tek fëmija im.

s2

**Strukturat e syve dhe të veshëve të fëmiut tim dhe strukturat e lindura të syve dhe veshëve**

b210

**Të pamurit**

Fëmiu im e njih dritën. Ai është në gjendje ta shohë formën, madhësinë dhe ngjyrën e objekteve.

s210-230

**Strukturat e syve të fëmiut tim**

b215

**Përpëlitje sysh, shkelje e syrit, mabjtje e shikimit dhe shikim i qartë**

Fëmija im mund të hap-mbyll sytë. Mund të lëvizë qepallat dhe të mbajë shikimin e tij ose të ndjekë lëvizjen e një objekti. Mund të qajë ose të shohë objektet qartë. Bebëzat e tij reagojnë ndaj dritës (për shembull, ata zvogëlohen nën ndikimin e dritës).

b220

**Ndjenja e presionit ose ndjenja e një trupi të huaj në sy**

Fëmija im mund të njohë kur sytë e tij janë të lodhur ose shumë të tensionuar. Ai e di kur sytë e tij janë të thatë, kur i kruhen dhe kur i djegin, ose kur janë irrituar. Fëmija është në gjendje të ndiejë presionin që qëndron pas kokërdhokut të syrit të tij ose të ndiejë një trup të huaj në sytë e tij.

b230

**Dëgjimi**

Fëmija im dëgjon tonet dhe tingujt dhe mund të vlerësojë nga vijnë. Mund të dallojë tonet e lartësive të ndryshme dhe forcën e tingujve të ndryshëm. Është në gjendje të njohë gjuhën.

s240-260

**Strukturat e veshëve të fëmiut tim**

b235

**Mbajtja e baraspeshës**

Veshi i brendshëm i fëmijës tim funksionon mirë. Fëmija im mund të mbajë ekuilibrin e tij. Ai njihë pozicionin e trupit të tij në hapësirë, për shembull, pozicionin e nyjeve ose kokës së tij. Fëmija im mund të njohë drejtimin e lëvizjes së tij.

b240

**Njohja e marramendjes, tingujve ose presionit në vesh**

Fëmija im mund të njohë marramendje dhe ndoshta vjellje të lidhura me të. Ai njihë ndjenjën e uljes (për shembull, në aeroplan). Mund të njohë tinguj në vesh (për shembull, gumëzhitje ose zhurmë në vesh) dhe presion në vesh.

b250

**Shije**

Fëmiju im mund ta ndjejë shijen kur është e hidhur, e ëmbël, e kripur ose e tharët.

**b255**

**Nuhatja**

Fëmiu im din ta dallojë erën e këndshme dhe jo të këndshme

**s310**

**Strukturat e hundës të fëmiut tim**

**b260**

**Përceptimi i pozicionit të trupit në hapësirë**

Fëmija im mund të vlerësojë pozicionin e trupit të tij në hapësirë, si dhe pozicionin dhe raportin midis pjesëve të ndryshme të trupit.

**b265**

**Prekja**

Fëmija im mund të njohë cilësitë dhe vetitë e ndryshme të një sipërfaqeje.

**b270**

**Ndjesia e temperaturës dhe stimujve të tjerë (të tilla si presioni dhe dridhja)**

Fëmija im ka një ndjesi për temperaturën, ethet, presionin, dridhjen ose kërcitje dhe stimuj të pakëndshëm.

**b280**

**Ndjesia e dhimbjes**

Fëmija im e njeh dhimbjen si një ndjenjë të pakëndshme (për shembull, një ndjesi djegieje, dhimbje të mprehtë ose vjellje). Kjo dhimbje mund të tregojë dëme të mundshme ose të dukshme.



b3 **Krijimi i zërit dhe të folurit**

Kjo pjesë ka të bëjë me krijimin e tingujve dhe të folurit tek femiu im.

b310

**Krijimi i zërit**

Fëmija im është në gjendje të krijojë tinguj, si dhe ton, me hapa të ndryshëm, me lartësi të ndryshme dhe cilësi të ndryshme të tingullit.

b320

**Krijon shenja të të folurit dhe përdor zërin**

Fëmija im mund të krijojë dhe shqiptojë tinguj dhe shenja të të folurit.

s320-340

**Strukturat e organeve për të folur dhe zëri i fëmijut tim**

b330

**Të folurit e rrjedhshëm**

Fëmiju im flet rrjedhshëm, me shpejtësi, ritëm dhe melodi të qëlluar.

b340

**Këndim, të folurit në rrokje, qarje dhe bërtima**

Fëmija im është në gjendje të krijojë tone të ndryshme me zërin e tij, të tilla si të këndim, fjalë me rrokje, qarje me zë të lartë ose të bërtima.

<b>b4</b> 	<p><b>Mënyra e punës së zembrës, qarkullimi, sistemi mbrojtës dhe frymëmarrja</b></p> <p>Kjo pjesë trajton mënyrën e funksionimit të zembrës dhe enëve të gjakut, si dhe qarkullimin (lëvizjen e gjakut në trup), sistemin imunitar (imunitetin) dhe frymëmarrjen.</p>
<b>s4</b>	<p><b>Organet dhe strukturat e zembrës, strukturat e sistemit për qarkullim, sistemit mbrojtës dhe sistemit për frymëmarrje të fëmiut tim</b></p>
<b>b410</b>	<p><b>Mënyra e punës së zembrës</b></p> <p>Zemra e fëmijës tim po pompon gjak në sasinë e duhur me presionin e duhur nëpër trupin e tij.</p>
<b>s410-420</b>	<p><b>Organet dhe strukturat e zembrës dhe strukturat e sistemit për qarkullim të fëmiut tim</b></p>
<b>b415</b>	<p><b>Lëvizja e gjakut nëpër trup</b></p> <p>Enët e gjakut të fëmijës tim (arteriet, venat, kapilarët) lëvizin gjakun në trupin e tij.</p>
<b>b420</b>	<p><b>Ruajtja e presionit të gjakut</b></p> <p>Trupi i fëmijës tim ruan presionin e tij të gjakut në vlera të qëndrueshme (korniza normale).</p>
<b>b430</b>	<p><b>Transferimi / lëvizja e substancave (për shembull, gjaku) në të gjithë trupin</b></p> <p>Trupi i fëmijës tim prodhon gjak, mbart oksigjen dhe produkte metabolike. Gjaku i tij i p[rshtatet mekanizmave të koagulimit.</p>
<b>s420</b>	<p><b>Strukturat të sistemit mbrojtës të fëmiut tim</b></p>

b435

**Reagimi ndaj sëmundjeve me sistemin e mbrojtjes**

Trupi i fëmijës tim ka sistem imunitar që funksionon mirë. Ai i përgjigjet trupave të huaj, sëmundjeve dhe inflamacionit. Përgjigja e tij mbrojtëse mund të jetë e lindur ose e fituar, për shembull kur trupi i tij është në gjendje të prodhojë antitropa ndaj shkaktuesve të rinj ose të ndryshuar të sëmundjes.

b440

**Frymëmarrja**

Fëmija im mund të marrë frymë dhe të nxjerrë frymën pa ndonjë problem. Numri i frymëmarrjeve dhe frymën xerjeve në minutë, ritmi dhe thellësia e frymëmarrjes janë të përshtatshme. Fëmija im merr ajër të mjaftueshëm.

s430

**Struktura të sistemit për frymëmarrje të fëmiut tim (mushkëri të bardha, bronhe)**

b445

**Muskujt e përfshirë në frymëmarrje ngrihen dhe bien**

Muskujt në kafazin e kraharorit që marrin pjesë dhe mbështesin frymëmarrjen e fëmijës tim funksionojnë mirë. Kjo vlen për diafragmën, muskulaturën skeletore midis brinjëve dhe muskujt që ndihmojnë në frymëmarrje

b450

**Kolitje, dihatje dhe gogësimë**

Fëmija im mund të kollitet, teshtisë, gogësojë, dihasë, si dhe të marrë frymë përmes gojës së tij. Sekretet mund të krijohen dhe transmetohen në përputhje me rrethanat.

**b455**

**Kryerja e aktiviteteve që kërkojnë qëndrueshmëri fizike**

Fëmija im mund të kryejë aktivitete që kërkojnë qëndrueshmëri fizike (për shembull: ecje, vrapim, not). Të gjithë organet e frymëmarrjes së fëmijës tim (mushkëritë, zgavra e hundës, sinuset, zgavra me gojë, fyti, trakea, bronkët, bronkiolet dhe alveolat) funksionojnë. Zemra dhe enët e gjakut ruajnë qarkullimin pa asnjë problem gjatë këtyre aktiviteteve.

**b460**

**Ndjenja e rrahjes së shpejtë të zemrës dhe mungesa e ajrit**

Fëmija im mund të njohë rrahjet e shpejta të zemrës, gulçim, shtrëngim në gjoks ose rrahje të parregullta të zemrës.

b5



### **Marrja e ushqimit, tretja dhe mirëmbajtja e rritjes së trupit**

Kjo pjesë merret me marrjen e ushqimit, tretjen dhe eliminimin (sekretimin) e ushqimit dhe proceset e tjera të metabolizmit tonë. Kjo vlen edhe për gjëndrat (tiroide, gjëndër paratiroide, gjëndrra e hipofizës, etj.) Si dhe nëse fëmijët rriten siç duhet.

s5

### **Struktura të sistemit digjestiv, sistemit hormonal dhe metabolizmit të fëmiut tim**

b510

### **Konsumimi i ushqimit**

Foshnja ime mund të thith, përtyp, kafshojë dhe hajë ushqime të ngurta dhe lëngje përmes gojës së tij. Mund të lëviz ushqimin me dhëmbët dhe gjuhën e tij, ta lagë me pështymë, ta pështyjë, ta gëlltisë dhe ta hedhë ose të vjellë.

s510-580

### **Struktura të gjëndrave të pështymes, kapërcyellit, lukthit, zorrëve, pankreasit, mëlçisë, fshiksës së tëmthit, kanalet e tëmthit dhe gjëndrat endokrine të fëmiut tim**

b515

### **Tretja e ushqimit**

Ushqimi që ha fëmija im kalohet në traktin tretës. Ky ushqim do të ndahet në lëndë ushqyese që do të apsorbohet nga zorrët. Fëmija im toleron ushqimin.

b520

### **Përpunimi i ushqimit**

Fëmija im mund të zërthejë ushqimin në pjesët përbërëse të tij dhe t'i ruajë ato.

b525

### **Largimi (eliminimi) i ushqimit**

Fëmija im mund të hedh ushqimin e pa përpunuar në formën e jashtëqitjes (feces).

**b530****Mbajtja e peshës së trupit**

Gjatësia dhe pesha e fëmijës tim janë të përshtatshme për moshën e tij. Fëmija im po fiton peshë sipas zhvillimit të trupit.

**b535****Ndjenja e fryrjes, mundimit dhe thartirave në lukth**

Fëmiju im mund të ndiejë funksionet tretëse që vijnë me ngrënie dhe pirje. Kjo mund të përfshijë: përkeqësim, të vjella, dhimbje barku, thartinë në lukth.

**b540****Thithja e karbohidrateve, yndyrave dhe proteinave**

Trupi i fëmijës tim mund të marrë (thith) përbërësit bazë të ushqimit, të tilla si karbohidratet, proteinat dhe yndyrnat, t'i rregullojë ato dhe t'i shndërrojë ato në energji.

**b545****Thithja e ujit, mineraleve dhe elektroliteve**

Trupi i fëmijës tim mund të thithë dhe rregullojë ujë, minerale (për shembull: zink dhe hekur) dhe elektrolite (natriumi dhe kaliumi).

**b550****Ruajtja e temperaturës së trupit**

Fëmija im është në gjendje të ruajë dhe rregullojë temperaturën e trupit të tij.

**b555****Krijimi i hormoneve**

Trupi i fëmijës tim krijon dhe rregullon hormonet e tij dhe ruan ekuilibrin e tyre. Ai gjithashtu përshtatet me ndryshimet e përsëritura. Gjëndrat që janë përgjegjëse për këtë (gjëndra e hipofizës, gjëndra tiroide, gjëndra mbiveshkore, gjëndra paratiroide dhe gjëndrat seksuale) funksionojnë mirë

**b560****Ruajtja e rritjes së trupit**

Fëmiju im po rritet dhe zhvillohet sipas moshës së tij.

b6



### Largimi i tepërt i lëngjeve (urinim) dhe riprodhimi (shumimi)

Kjo pjesë merret me eliminimin (largimin) e lëngjeve të tepërta (urinim) dhe riprodhimin (shumimin).

s6

### Struktura të organeve për urinim dhe riprodhim të fëmijut tim

b610

### Sekretimi i urinës

Urina ekskretohet dhe mblihet.

s610-620

### Struktura të organeve për urinim (ujëpërcjellësi, fshikëza e urinës) dhe fundi i pelvisit të fëmijut tim

b620

### Urinimi

Fëmija im urinon pa asnjë problem. Ndodh shpesh dhe në mënyrë të përshtatshme.

b630

### Ndjenja e fshikëzës së zbrazët

Kur urinon, fëmija im ka ndjenjë të zbrazjes së plotë të fshikëzës.

b640

**Funksionet e nevojshme për marrëdhënie seksuale**

Fëmija im - në moshën e duhur - ka funksionet mendore dhe fizike të nevojshme për marrëdhënie seksuale (seks). Kjo i referohet fazave të ngjalljes seksuale, paralojës, orgazmës dhe në fund - relaksimit. Kjo gjithashtu përfshin interesin seksual (të përshtatshme për moshën), ngritje (ngacmim) të penisit dhe klitoris, lagjen e vaginës tek gratë, aftësinë për orgazëm, vetë-kënaqjen ose derdhjen në orgazmën e një burri.

s630

**Struktura të lidhura me organet për riprodhim të fëmiut tim**

b650

**Cikli menstrual**

Tek adoleshentet paraqitet gjakderdhje e rregullt mujore, e cila përsëritet çdo 28 ditë. Forca e lëngut menstrual (gjaku) është i përshtatshëm.

b660

**Shumimi**

Kjo i referohet pjellorisë ose aftësisë për të riprodhuar. Trupi i adoleshentes është në gjendje të ngjiz, konceptojë dhe lind fëmijë. Sekretohet qumështi i nevojshëm për ushqyerjen me gji.

b670

**Ndjesitë që lidhen me menstruacionet dhe marrëdhëniet seksuale**

Një adoleshent ose adoleshente mund të ndjehet pakëndshëm gjatë marrëdhënieve seksuale dhe menstruacioneve nëse ka një problem në këtë fushë.



b7

**Lëvizjet**

Kjo pjesë merret me lëvizshmëri dhe lëvizje, përfshirë funksionet e nyjeve, kockave, reflekseve dhe muskujve.

s7  
(s710-770)

**Struktura të lidhura me lëvizshmërin e fëmijut tim (strukturat e kokës, qafës, shpatullës, ekstremitetet e sipërme, ekstremitetet e poshtme, duart, këmbët, boshti kurizor, trupi, eshtrat, muskujt, nyjet)**

b710

**Lëvizja e nyjeve**

Fëmija im mund të lëvizë nyjet e tij në mënyrë të rregullt. Lëviz lehtë një ose më shumë nyje (shpinë, shpatull, bërryl, dore, gju, kyçin e këmbës dhe nyje të vogla të duarve dhe këmbëve).

b715

**Stabiliteti i nyjeve**

Nyjet e fëmijut tim janë stabile.

b720

**Lëvizja e kockave**

Fëmija im mund t'i lëviz kockat e tij në mënyrë të rregullt. Lëviz lehtësisht shpatullën, tehun e shpatullave, legenin dhe kockat e dorës dhe këmbës.

b730

**Ka forcë të mjaftueshme të muskujve**

Fëmija im ka forcë të mjaftueshme për të tensionuar muskujt e caktuar. Kjo vlen për grupet më të mëdha të muskujve, muskujt e gjymtyrëve të tij (krahët dhe këmbët), muskujt e gjysmës së trupit, si dhe trungun dhe tërë trupin.

**b735****Tensioni i muskujve**

Muskujt e fëmijës tim janë të tensionuar në mënyrë të rregullt.

**b740****Qëndrueshmëria e muskujve**

Fëmija im është në gjendje të tensionojë disa muskuj, grupe të muskujve ose të gjithë muskujt në një periudhë të caktuar (më të gjatë).

**b750****Reagime me reflekse**

Fëmija im po tregon tension të pavetëdijshëm të muskujve. Tensioni mund të shkaktohet nga stimuj të caktuar (për shembull, reflekset)

**b755****Lëvizja e pavetëdijshme (për të ruajtur baraspeshën e trupit)**

Tek fëmija im, muskujt e mëdhenj ose i tërë trupi pavetëdijë tensionohen. Kjo mund të ndodhë, për shembull, kur ndryshon pozicionin e trupit të tij, kur ai përmbahet të mos bjerë, kur është i frikësuar ose kur dëshiron të mbrohet nga diçka.

**b760****Kontroll i vetëdijshëm i lëvizjeve**

Fëmija im është në gjendje të koordinojë dhe kontrollojë lëvizjet e thjeshta dhe komplekse të dëshiruara (të qëllimshme). Është në gjendje me vetëdije dhe me qëllim të kryejë lëvizje aktive (për shembull, të mbështetet në krahët dhe këmbët, të koordinojë sytë dhe duart dhe kështu me radhë.

**b761****Lëvizje spontane**

Fëmija im mund të lëvizë vetë. Për shembull, kemi një lëvizje të tillë kur foshnjat shtyhen me këmbë.

**b765****Lëvizja e pavetëdijshme (pa qëllim) (për shembull, teknika ose lëvizje të njëjta që përsëriten vazhdimisht)**

Kjo vlen për lëvizjet që nuk mund të kontrollohen gjithmonë nga fëmija im, për shembull: tiket, dridhje ose të njëjtat lëvizje përsëritëse (kjo nganjëherë quhet stereotipizim, siç është lëkundja para mbrapa , luhatja e trupit ose pohime me kokë.

**b770****Ecja dhe mënyra e ecjes**

Lëvizjet e fëmijës tim kur ec, vrapon dhe kur bën lloje të tjera të lëvizjeve janë të përshtatshme. Kjo mund të vlejë, për shembull, në mënyrën se si ecën një fëmijë, d.m.th., nëse fëmija përkulet ose ecë me vendosshmëri.

**b780****Ndjesia e muskujve kur lëviz (për shembull: ngërçe)**

Fëmija im ndjen muskujt e tij duke lëvizur. Kjo gjithashtu mund të çojë në ngërçe të muskujve dhe tensionim i tyre.

b8

**Lëkura dhe shtojcat e lëkurës**

Kjo pjesë ka të bëjë me funksionimin e lëkurës, thonjëve dhe flokëve.

s8

(s810-840)

**Lëkura dhe strukturat e lindura të femiut tim (si gjendrat e djersitjes, thonjët dhe flokët)**

b810

**Mbrojtja përmes lëkurës**

Lëkura e fëmijës tim mbron trupin e tij nga ndikimet e dëmshme (për shembull, rrezet e diellit ose ngacmuesit ose irrituesit e tjerë). Lëkura e tij është në gjendje të rregullojë nxehtësinë dhe shërimin.

b820

**Shërimi i plagëve të lëkurës (formimi i zgjebeve dhe i shenjave)**

Lëkura e fëmijës tim është në gjendje të shërohet nga plagët, presionet ose dëmtimet e tjera. Kjo ndodh, për shembull, përmes formimit të zgjebeve dhe shenjave.

b830

**Djersitja dhe era e trupit**

Lëkura e fëmijës tim është në gjendje të ftohet përmes djersitjes dhe kështu të krijojë erën e djersitjes.

b840

**Ndjen irritime në lëkurë**

Fëmija im ndien dhe njuh stimujt në lëkurën e tij, për shembull: kruajtje, djegie dhe shpuarje.

**b850****Flokët**

Flokët e fëmijës tim përmbushin detyrën e vet, për shembull: mbrojtja e kokës, ngjyra dhe pamja. Flokët e tij rriten siç duhet dhe në vendet e duhura.

**b860****Thonjtë**

Thonjtë e fëmijës tim përmbushin detyrën e tyre, të tilla si: mbrojtja e gishtit, mundësia për kuarje dhe pamja. Thonjtë e tij rriten siç duhet dhe në mënyrë të duhur.





## d Aktivitetet dhe pjesëmarrja



d1 Të mësojë diçka dhe ta zbatojë diturin e tij



d2 Ballafaqimi me detyrat dhe kërkesat e përgjithshme



d3 Komunikimi



d4 Lëvizja



d5 Kujdesi për veten



d6 Jeta në shtëpi



d7 Interaksioni dhe sjellja me njerëzit e tjerë



d8 Pjesëmarrja në fusha të rëndësishme të jetës (arsim, profesion, ekonomi)



d9 Pjesëmarrja në komunitet, shoqëri dhe jetën civile.

d

**Aktivitetet dhe pjesëmarrja**

Pjesëmarrja i referohet gjithçkaje që fëmijët duan dhe mund të bëjnë në krahasim me fëmijët e tjerë.

d1

**Të mësojë diçka dhe ta zbatojë diturin e tij**

Kjo pjesë ka të bëjë me atë se si fëmija im mëson, si përdor atë që ka mësuar, si mendon, si zgjidh problemet dhe si merr vendime.

d110

**Shikimi**

Fëmija im mundet me qëllim të shikojë dhe gjatë asaj kohe edhe të mësojë. Ai vëzhgon lëvizjet, mund të ndjekë lëvizjen e sendeve me sytë e tij ose vëzhgon fëmijët duke luajtur ose njerëz të tjerë.

d115

**Dëgjimi**

Fëmija im mund me vetë iniciativë të dëgjojë dhe të mësojë. Ai njuh tingujt përreth tij, për shembull nga radio, zëri njerëzor, muzika, mund të dëgjojë një leksion ose një përrallë.

d120

**Shijim, nuhatje prekje dhe shqisa të tjera**

Fëmija im mund të përdorë qëllimisht shqisat e tjera (shijen, erën, prekjen) dhe përgjatë asaj edhe të mësojë. Ai ndjen kur diçka është e shijshme ose kur diçka ka erë të mirë. Kështu, për shembull, mund të prekë sipërfaqe të ndryshme, të shijojë ëmbëlsinë ose të nuhasë lule.

d130

**Emitimi**

Fëmija im mund të imitojë diçka ndërsa mëson. Mund për shembull, të imitojë një shprehje të fytyrës ose një gjest, por gjithashtu mund të imitojë një tingull ose të vizatojë një figurë.



d131

**Mësim duke trajtuar objektet (duke u shtirur)**

Fëmija im mund të luajë me një, dy ose më shumë objekte ndërsa mëson. Do të thotë mund të shtiret: për shembull, mund tëgodasë me një objekt sikur të jetë çekiç. Por gjithashtu mund të nënkuptojë që fëmija mund të aplikojë dhe të luajë me një lodër sipas qëllimit të tij, për shembull, duke luajtur me kukulla ose makina.

d132

**Përvetsimi i njohurive**

Përdorimi i pyetjeve (pse, çfarë, ku, kur dhe si) fëmija im merr informacione për njerëzit, objektet dhe ngjarjet, ose pyet njerëzit për emrat e tyre. Përmes saj, fëmija im fiton njohuri.

d133

**Mësim i gjuhëve**

Fëmija im mëson të përdorë fjalë, simbole, shprehje dhe fjali për të folur për diçka ose për të shprehur ndjenjat e tij. Ai emërton objekte, si dhe flet për personalitete dhe ngjarje.

d134

**Mësim i një gjuhë shtesë (për shembull, një gjuhë e huaj ose gjuhën e shenjave)**

Fëmija im mëson me ndihmën e një gjuhe tjetër (gjuhën e shenjave ose gjuhë tjetër të huaj) si të flasë për diçka ose të shprehë ndjenjat e tij. Ai emërton objekte ose bisedime për personalitete dhe ngjarje.

d135

**Ushtrime**

Fëmija im ushtron dhe zbaton njohuritë e tij. Përsërit fazat, të tilla si numërimi i dhjetësheve (10-20-30) ose ushtrimi i këngëve.

d137

**Adoptimi i nocioneve (koncepteve)**

Fëmija im përvetëson njohuri dhe kupton konceptet themelore për objektet, njerëzit dhe ngjarjet. Mund të jenë, për shembull, madhësia, forma, barazia, diversiteti ose diçka tjetër.

d140

**Mësimi i leximit**

Fëmija im mëson të lexojë rrjedhshëm dhe saktë atë që ka shkruajtur. Kjo vlen, për shembull, për (alfabetin e shenjave). Fëmija im mund të njohë saktë shenjat ose shkronjat. Ai mund t'i shqiptojë fjalët saktë.

d145

**Mësim i shkrimit**

Fëmija im mëson që fjalët ose fjalitë të shkruajë saktë dhe përdor sintaksën e duhur.

d150

**Mësimi i llogaritjes**

Fëmija im mëson të përdorë numra si dhe detyra të thjeshta me mbledhje dhe zbritje dhe di të përdorë operacionet e sakta matematikore për secilën nga këto detyra.

d155

**Fitimi i aftësive**

Fëmija im zhvillon aftësi themelore dhe gjithëpërfshirëse. Në atë mënyrë, ai mund të trajtojë aktivitete dhe detyra komplekse. Për shembull, një fëmijë mund të përdorë mjete të ndryshme ose të luajë lojëra komplekse, siç është shahu.

d160

**Përqëndrimi i vëmendjes**

Fëmija im mund të përqendrojë vëmendjen e tij në një ngjarje, një person ose një objekt dhe të injorojë ose të lë anash tingujt që i pengojnë.

d161

**Drejtimi i vëmendjes**

Fëmiu im është në gjendje të përqendrojë vëmendjen e tij në një ngjarje ose detyrë të veçantë gjatë një periudhe kohore.

d163

**Të menduarit**

Fëmiu im mund ti shprehë dhe realizojë , idetë mendimet dhe shfaqjet e tij. Është në gjendje të trillojë dhe imagjinojë situata për të ardhmen vetëm ose me të tjerët. Mund të bëjë plane, të luajë lojëra të trilluara, të vlerësojë pikat e forta dhe të dobëta dhe të bëjë supozime dhe mendime.

d166

**Leximi**

Fëmiu im mund të mësojë kuptimin e tekstit që po lexon. Mund të lexojë nga librat, udhëzimet ose gazetatat ose mund të lexojë alfabetin e shenjës (Brajllit). Në atë mënyrë ai fiton njohuri.

d170

**Shkrimi**

Fëmiu im mund të përdor shkronja, shenja, numra ose fjalim për të përcjellë informacione te njerëzit e tjerë. Mund të përshkruajë ngjarje ose ide në formë të shkruar ose të shkruaj një e-mail ose mesazh.

d172

**Llogaritja**

Fëmiu im është në gjendje të zgjidhë problemet e matematikës dhe të përdorë saktë operacionet matematikore (për shembull, për të mbledhur tre numra).

d175

**Zgjidhja e problemeve**

Fëmiu im mund të gjejë një zgjidhje për një problem apo situatë. Mund të zbulojë saktësisht se cili është problemi. Gjen mënyra të ndryshme për të zgjidhur problemin dhe mendon për efektet e mundshme të këtyre zgjidhjeve. Ai më pas gjen zgjidhjen e duhur dhe e zbaton atë (për shembull, ndihmon në një grindje midis dy personave).

## d177

**Sjellja e vendimeve**

Fëmiu im mund të vendosë midis dy mundësive. Ai mund të zbatojë vendimin e tij dhe të vlerësojë pasojat. Fëmiu mund, për shembull, të vendosë për një artikull dhe ta blejë atë. Ose mund të vendos për një nga më shumë detyrat që duhet të bëhen dhe ta kryen atë.

d2



### **Ballafaqimi me detyrat dhe kërkesat e përgjithshme**

Kjo ka të bëjë me një ose më shumë detyra. Kjo gjithashtu vlen për detyrat që përsëriten pa pushim ose në baza ditore, si dhe ballafaqimi me stresin.

d210

### **Ballafaqimi me detyrat individuale**

Fëmiju im mund të kryejë detyra individuale. Këto detyra mund të jenë të thjeshta ose të vështira. Ai di si t'i kryejë këto detyra. Ai e di se sa kohë, çfarë hapësirë dhe çfarë materialesh i duhen. Fëmiju im mund të përcaktojë hapat individualë të nevojshëm dhe më pas të kryejë plotësisht detyrën.

d220

### **Ballafaqimi me më shumë detyra (ose detyra me shumë hapa)**

Fëmiju im mund të ndërmarrë aktivitete dhe detyra me shumë hapa dhe t'i zbatojë ato hap pas hapi ose të punojë në disa hapa në të njëjtën kohë. Detyrat mund të jenë të thjeshta ose të vështira. Fëmija im mund të kryejë detyrat deri në fund. Mund t'i marrë këto detyra vetëm ose në një grup.

d230

### **Kryerja e rutinës së përditshme**

Fëmija im mund të planifikojë, ndërmarrë dhe të kryejë detyra dhe përgjegjësi të përditshme. Kjo vlen, për shembull, për veshjen, ngrënien e mëngjesit dhe përgatitjen për shkollë. Fëmija im mund të planifikojë kohën e nevojshme për të gjitha këto aktivitete ose të përgatisë një plan për ditën dhe ta kryejë atë deri në fund.

d240

**Ballafaqimi me stresin dhe kërkesat e tjera mendore**

Fëmija im mund të kryejë detyra që kërkojnë përgjegjësi të veçantë. Kjo vlen, për shembull, për ballafaqimin me stresin, sëmundjen ose situatat e vështira. Fëmija im është në gjendje t'i menaxhojë dhe të ballaahqohet me këto situata. Për shembull, marrja e provimeve (në varësi të moshës), veshja nën presion nga prindërit, kryerja e një detyre brenda një kohe të caktuar, etj.

d250

**Menaxhimi me sjelljen e vet**

Fëmija im mund të kryejë detyra të thjeshta ose komplekse dhe të vështira në një mënyrë të përshtatshme. Mund të merret me situata , personalitete dhe përvoja të reja (për shembull, të silllet me qetësi në një librari) dhe të reagojë në mënyrë të duhur.

d3

**Komunikimi**

Kjo pjesë ka të bëjë me komunikimin tonë. Kjo mund të vlejë për të folmen, si dhe për shenjat ose simbolet. Kjo do të thotë që një mesazh i dërguar nga njëra anë do të kuptohet nga ana tjetër, gjithashtu kjo mund të lidhet edhe me përdorimin e mjeteve të ndryshme dhe teknikave të komunikimit (për shembull, një telefon celular).

d310

**Ai kupton atë që thuhet**

Fëmija im është në gjendje të kuptojë kuptimin e mirëfilltë dhe figurativ të mesazheve të transmetuara. Kupton, për shembull, nëse ato që janë thënë korrespondojnë me faktin ose është thënë vetëm "pro forma".

d315

**Kupton shprehjet e fytyrës dhe gjestet**

Fëmija im mund të kuptojë kuptimin e asaj që thuhet përmes shprehjeve të fytyrës, gjesteve ose simboleve: për shembull, a është i lodhur një fëmijë kur fërkon sytë ose tingulli i një sirene a do të thotë zjarr?

d320

**E kupton gjuhën e shenjave**

Fëmija im mund të pranojë dhe kuptojë kuptimin e mesazheve në gjuhën e shenjave.

d325

**Kuption mesazhe të shkruara dhe tekste**

Fëmija im mund të kuptojë kuptimin e mesazheve të shkruara (për shembull, kur lexon një përrallë). Kjo vlen gjithashtu për mesazhet ose tekstet e shkruara me alfabetin e Brailles për njerëzit shikim të dëmtuar.

d330

**E folura**

Fëmija im mund të shprehet gojarisht me fjalë, fjali, shprehje ose fragmente më të gjata. Për shembull, mund të tregojë një histori ose të tregojë fakte.

d331

**Krijimi i tingujve dhe gjesteve**

Fëmija im krijon dhe lëshon tinguj kur vëren një person tjetër rreth tij. Për shembull, ai krijon dhe lëshon tinguj kur nëna e tij është afër. Mund të prodhojë "da-da-da" ose "ga-ga-ga". Fëmiju bërbelit në dialog si përgjigje të asaj që thuhet. Mundohet të imitojë tinguj.

d332

**Këndimi**

Fëmiju im mund të këndojë duke lidhur tonet, duke krijuar një melodi ose këngë. Ai këndon kur është vetëm ose këndon në një grup.

d335

**Gjestet (me përdorimin e gjuhës së trupit) dhe përdorimi i shenjave të tjera jo-gjuhësore**

Fëmija im mund të përdorë gjeste, simbole ose vizatime për të përcjellë atë që ai mendon ose dëshiron. Për shembull, kthen kokën të tregojë se nuk pajtohet ose të përgjigjet "jo". Për shembull, mund të vizatojë një vizatim për të shprehur ose shfaqur diçka.



d340

**Krijimi i mesazheve në gjuhën e shenjave**

Fëmiu im mundet ta përdor gjuhën e shenjave dhe të përqon mesazhe nëpërmjet saj.

d345

**Shkruan mesazhe**

Fëmiu im mund të shkruajë një mesazh me ndihmë të fjalëve, të tilla si shkrimi i një mesazhi, shkrimi i ndonjë poste elektronike ose shkrimi i një letre shokut.

d350

**Bisedon**

Fëmija im mund të flasë me një ose më shumë njerëz (të njohur ose të panjohur). Duke vepruar kështu, idetë ose mendimet do të shkëmbehen në formën me gojë, me shkrim ose në gjuhën e shenjave. Fëmija fillon bisedën, bisedon dhe mbaron bisedën.

d355

**Diskuton**

Fëmiu im shkëmben mendimet dhe idetë e tij me një ose më shumë njerëz (të njohur ose të panjohur), i shpjegon ato dhe jep argumente nëse ai pajtohet apo jo. Fëmiu mund ta bëjë këtë gojarisht, me shkrim ose në gjuhën e shenjave. Fëmiu im mundet bisedat e tilla (për shembull, grindjet) ti fillojë, ti mbajë dhe ti përfundojë.

d360

**Përdorimi i mjeteve dhe paisjeve për komunikim**

Fëmiu im mund të përdor mjete për komunikim (kompjuter, telefon dhe telefon të mençur të tipit smatfon) dhe përshembull ti lajmërohet ndonjë shoku të vet në telefon.

d4 **Lëvizja**

Kjo pjesë i referohet lëvizjeve të vetë trupit që ndodhin duke ndryshuar pozitën e trupit, pozicionin e tij, ose duke ndryshuar vendin e trupit nga një vend në tjetrin. Kjo përfshin edhe lëvizshmërinë e objekteve duke i bartur ose duke i përdorur ato (për shembull, mbajtja e stilolapsit, hedhja e një topi), si dhe mënyra e lëvizjes, si ecja, vrapimi, ngjitja, si dhe planifikimi ose duke përdorimi i një automjeti (biçikletë me tre rrota, rolera, karrige për njerëz me invaliditet).

d410

**Ndryshimi i pozicionit të trupit (për shembull, shtrihet, përkulet, kthehet)**

Fëmiu im mund të ndryshojë pozicionin e trupit nga njëra anë në tjetrën. Mund të kthehet nga njëra anë në tjetrën, të ulet, të ngrihet, të ngrihet nga një karrige ose, për shembull, të lëvizë nga një vend në tjetrin (të shtrihet në shtrat).

d415

**Mbajtja e pozitës trupore**

Fëmija im mund të qëndrojë në një pozicion të caktuar nëse është e nevojshme. Për shembull, të ulet për një kohë të caktuar në një karrige.

d420

**Zhvendosja**

Fëmiu im mund të ndryshojë pozicionin e trupit dhe të lëvizë. Për shembull, ai mund të rrëshqasë përgjatë gjatësisë së një bange ose të dalë nga shtrati dhe të ulet në një karrige.

d430

**Ngritja dhe mbajtja e objekteve**

Fëmiu im është në gjendje të përdorë duart, krahët, shpatullat, kokën, shpinën dhe vithet për të ngritur objekte dhe për t'i lëvizur ato nga një vend në tjetrin. Për shembull, ai mund të marrë një gotë ose një lodër, ose mund të lëvizë një kuti nga një dhomë në tjetrën.

d435

**Zhvendosja e objekteve me shputa dhe këmbë**

Fëmiu im mund të lëvizë objekte me ndonjë qëllim të caktuar me ndihmën e shputave dhe këmbëve të tij. Për shembull, ai mund të godet një top ose ti rrotullon pedalet e një biçiklete.

d440

**I përdor gishtat dhe (pëllëmbën e dorës)**

Fëmija im mund të prek objektet me ndihmën e pëllëmbës së dorës, gishtat dhe gishtin e madh, dhe të njejtat mund t'i marr, t'i mbajë dhe t'i lëshojë. Për shembull, ai mund të marrë para nga një tavolinë ose të përdorë një smartphone me gishtat e tij.

d445

**Përdorimi i pëllëmbës dhe i dorës**

Fëmiu im mund të lëvizë dhe të përdorë objekte me pëllëmë të dorës dhe krahë, për një qëllim të caktuar. Për shembull, ai mund të lëvizë rrezen e derës ose të hedhë dhe të kapë një top, gjithashtu ai mund të tërheqë ose të shtyjë diçka.

d446

**Përdorimi i shputave dhe gishtave të këmbës**

Fëmiu im me ndihmën e shputave dhe gishtave të tij të këmbës të lëvizë objekte dhe të njejtat ti mbajë.

d450

**Ecja dhe lëvizja**

Fëmiu im mund të ecë me lëvizjen e këmbëve mbi sipërfaqe hap pas hapi dhe në këtë mënyrë të lëvizë. Në mënyrë që një këmbë të jetë gjithmonë në tokë, si për shembull kur ec përpara, prapa ose anash.

d455

**Ai lëviz në mënyrë tjetër (për shembull duke vrapuar, zvarritur, ngjitur, notuar)**

Fëmiu im është në gjendje, përveç ecjes, të lëvizë në mënyra të tjera, për shembull, të ngjitet në një shkëmb, të vrapojë përgjatë një shtegu, të bën sallta me kokë, të kërcejë, të kërcejë lart, dhe ti shmangë pengesat. Të zvarritet në sipërfaqe, të rrëshqasë, të notojë të garojë duke vrapuar etj.

d460

**Ai lëviz në ambiente të ndryshme**

Fëmiu im mund të lëvizë në ambiente dhe hapësira të ndryshme. Për shembull, në shtëpi ose ndërtesë mund të lëvizë nga një dhomë në tjetrën, të vrapojë përgjatë një rruge, të vrapojë rreth shtëpisë së vet, të ngjitet shkallëve, të shkojë nga kati në kat ose të ecë nëpër ndërtesa të panjohura.

d465

**Lëvizje me ndihmën e paisjeve (për shembull me karrige të invalidëve)**

Fëmija im është në gjendje të lëvizë me ndihmën e pajisjeve, të tilla si një skateboard, skija ose karrige me rrota. Ai mund të përdor patina, skateboard, skija shapka noti ose rrëshqitëse. Fëmija im është në gjendje - pavarësisht nga mjedisi - të lëvizë nga një vend në tjetrin.

d470

**Përdorimi i mjeteve të transportit (për shembull, vozitet me karrocë të fëmijëve me autobus / taksi)**

Fëmiu im është në gjendje të përdorë mjetet e transportit si pasagjer dhe të lëvizë me to. Për shembull, atë mund ta shëtisin me një karrocë të fëmijëve. Fëmija mund të hipë në një makinë, autobus, varkë, karrocë, taksi, tren, metro, anije ose aeroplan.

d475

**Nget "automjete" si triçikël, biçikletë dhe trotinet.**

Fëmiu im mund të drejtojë dhe të lëvizë një automjet (për shembull, një triçikël ose trotinet) dhe kështu të lëvizë në mënyrë të pavarur.

d480

**Kalërimi i kafshëve për të lëvizur (transportuar)**

Fëmiu im është në gjendje të kalërojë një kafshë dhe kështu të lëvizë (për shembull në kalë, në ujë në, deve ose elefant).

d5 **Kujdesi për veten**

Kjo pjesë merret me kujdesin për veten. Këto përfshijnë larjen, tharjen kujdesin për trupin dhe pjesët e tij, veshjen dhe zhveshjen, ngrënien dhe pirjen, dhe kujdesjen për shëndetin.

d510

**Vetë-pastrimi**

Fëmiu im është në gjendje të lajë trupin dhe pjesët e trupit të tij me ujë, shampon dhe mjete të tjera dhe pastaj të fshihet me një leckë. Për shembull, fëmiu lahet, bën dush dhe lan duart, këmbët, fytyrën dhe flokët.

d520

**Kujdesi për pjesët e trupit (kreh flokët, lan dhëmbët, lyhet me krem)**

Përveç larjes dhe tharjes, fëmija im është në gjendje të kujdeset shtesë për lëkurën, fytyrën, dhëmbët, kokën, thonjtë dhe organet gjenitale. Kjo do të thotë që fëmija im mund të lyhet me krem, të lajë dhëmbët dhe të presë thonjtë.

d530

**Shkuarja në toalet (wc)**

Fëmiu im e ndjen kur duhet të shkojë në tualet për të eliminuar urinën (urinën), jashtëqitjen ose gjakun menstrual. Është në gjendje ta parashikojë këtë, ta zbatojë atë dhe më në fund ta fshijë.

d540

**Veshja**

Fëmiu im me rregullin e duhur mund të vesh ose të zhvesh roba dhe mbathje. Duke vepruar kështu, fëmija im merr parasysh si është moti, çfarë sezoni është dhe për çfarë rasti duhet të vishet (për shembull, këmisha, funde, bluza, pantallona, veshje të brendshme, triko, kapelë, doreza, xhaketa, pallto, çizme, këpucë, sandale ose pantofla).

d550

**Ushqimi**

Fëmija im mund të tregojë kur është i uritur. Ai mund ta vendos ushqimin e përgatitur në gojën e tij dhe ta hajë në mënyrë të rregullt. Fëmiju im mund të presë ose copëtojë ushqimin në copa, të hap shishe ose kanaçe të ndryshme dhe të përdorë një thikë, pirun dhe lugë për të ngrënë vaktin e tij.

d560

**Pirja (e lëngjeve)**

Fëmiju im mund të tregojë kur ka etje. Është në gjendje të merr pijen në dorë, ta sjellë te goja dhe të pijë në mënyrë të rregullt. Është në gjendje të përziën lëngje për pirje (për shembull, ujë mineral me lëng), t'i përziën ato, t'i vendos në një gotë, të hap një shishe ose kanaçe, të pin nga një çezmë ose shatërvan. Foshnjat mund të thithin nga gjiri.

d570

**Kujdeset për shëndetin**

Sipas moshës së tij, fëmija im mund të kujdeset për shëndetin e tij fizik dhe mendor. Për shembull, për të ngrënë siç duhet, për të ushtruar dhe për të lëvizur, për t'u ngrohur ose për t'u ftohur sipas nevojës. Kjo vlen gjithashtu edhe për shmangien e gjërave që janë të dëmshme për shëndetin. Tek adoleshentët, kjo vlen, për shembull, për seksin e sigurt përmes përdorimit të prezervativëve ose, për shembull, kontrollet e rregullta tek mjeku.

d571

**Kujdeset për sigurin e tij**

Fëmiju im shmang situatat e rrezikshme që mund të çojnë në lëndime ose vuajtje. Kjo mund të përfshijë, për shembull, abuzimin me zjarrin ose sjelljen e rrezikshme në trafik.

d6



### Jeta në shtëpi

Kjo pjesë ka të bëjë me kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe aktiviteteve të përditshme. Fushat e të jetuarit në shtëpi kanë të bëjnë me sigurimin e mjeteve për jetesë si veshmbathjen ose hapësirën e jetesës, si dhe gjëra të tjera të nevojshme: pastrimin dhe riparimet në shtëpi, mirëmbajtjen e sendeve personale dhe të tjera shtëpiake, ndihmë për të tjerët. Për fëmijë shumë të vegjël, disa nga këto aktivitete nuk janë gjithmonë shumë të rëndësishme.

d610

### Gjetja e një vendi për të jetuar

Fëmiu / adoleshent (nëse është i aplikueshëm për sa i përket moshës) është në gjendje të organizojë hapësirën e jetesës sipas moshës së tij / saj (për shembull, të regullojë dhomën e tij / saj ose të organizojë një vendbanim tjetër).

d620

### Sigurimi i produkteve dhe përdorimi i shërbimeve (për shembull, blerja)

Fëmiu im / adoleshent (nëse është i aplikueshëm sipas moshës) është në gjendje në bazë të moshës së tij të blejë gjërat që i nevojiten në përditshmëri dhe t'i bart ato, për shembull: ushqim, pije, veshje, furnizime pastrimi, karburant ( p.sh. dru për ngrohje), mjete të nevojshme për shtëpi psh takëmet si tenxhere dhe tigan, lodra. Është në gjendje të zgjedhë mjetet e duhura ndihmëse si (lugë / pirun) dhe mjetet (lugë drurit).

d630

**Përgatitja e ushqimit**

Fëmiu im / adoleshent (nëse aplikohet për sa i përket moshës), në përshtatshmëri me moshën e tij, mund të përgatisë ushqime të thjeshta ose më komplekse për veten e tij (për shembull, bukë me gjalpë). Fëmija mund ta planifikojë këtë, të blejë të nevojshmen, të gatuj dhe të vendosë tryezën. Fëmija im mund të zgjedh pije ose përbërësit e duhur për një vakt dhe ta përgatisë atë.

d640

**Kryerja e detyrave të shtëpisë**

Fëmiu im / adoleshent mundet (nëse është i aplikueshëm për sa i përket moshës), në bazë të moshës së tij të mirëmbajë amvisërinë ose të ndihmojë në shtëpi. Për shembull, fëmija im e mban dhomën e tij të pastër. Ruan ushqim në frigorifer, ndihmon në largimin e mbeturinave dhe ruan rendin në shtëpi. Fëmiu im i mbledh rrobat e papastërta dhe me ndihmën e një fshese, furçe, leckë dhe me ndihmë të fshesës me korrent ai i largon papastërtitë në shtëpi.

d650

**Kujdesi për gjërat shtëpiake**

Fëmiu im / adoleshent mund të (nëse aplikohet sipas moshës) të kujdeset për sendet shtëpiake sipas moshës së tij . Për shembull, ai i përdor lodrat e tij me kujdes dhe i mban rrobat e pastra. Ai gjithashtu kujdeset për lulet duke i ujitur dhe duke u kujdesur për to ose duke ushqyer kafshët.

d660

**Ndihma ndaj të tjerëve**

Fëmiu im / adoleshent - sipas moshës së tij - ndihmon anëtarët e tjerë të familjes. Kjo, për shembull, ndihmon në mirëmbajtjen dhe kryerjen e detyrave të shtëpisë. Ai kujdeset për mirëqenien e anëtarëve të familjes së tij dhe mund të sigurojë ndihmë nga individë të tjerë për mirëqenien e anëtarëve të familjes.



d7



### **Interaksioni dhe sjellja me njerëzit e tjerë**

Kjo pjesë ka të bëjë me atë se si njerëzit veprojnë ndërmjet veti dhe si e trajtojnë njëri-tjetrin (për shembull, familjen, miqtë, të afërmit, partnerët, eprorët ose të huajt) në një mënyrë të rregullt dhe i përshtatet situatës.

d710

### **Krijimi i marrëdhënieve fillestare me të tjerët (krijimi i komunikimit, lidhja fizike me të tjerët), duke treguar respekt dhe mirënjohje ndaj të tjerëve**

Fëmiu im është në gjendje të kontaktojë me njerëz të tjerë sipas situatës. Për shembull, mund të tregojë vëmendjen dhe mirënjohjen e nevojshme (si psh me njerëzit e moshuar). Mund të pranojë ndjenjat e të tjerëve ose të tregojë respekt, ngrohtësi dhe tolerancë në marrëdhënie.

d720

### **Krijimi i marrëdhënieve komplekse me të tjerët (loja të përbashkëta, gjetja e miqve, krijimi i një rrethi me njerëz që i njeh)**

Fëmiu im është në gjendje të ruajë marrëdhënie komplekse me të tjerët në një mënyrë të përshtatshme për situatën dhe të kontrollojë emocionet dhe sjelljen e tij. Ai sillet sipas rregullave dhe normave shoqërore dhe për shembull, mund të luajë me të tjerët, të krijojë lidhje, t'i ndërpret ato ose t'i mbajë ato në distancë.

d730

### **Vendosja e kontakteve me njerëz të panjohur**

Fëmiu im është në gjendje të kontaktojë të huajt në mënyrë që, për shembull, të pyesë se sa është ora, të pyes për drejtimin e rrugës ose gjatë blerjes në arkë.

d740

**Vendosja e marrëdhënieve me njerëzit në pozicione të ndryshme (bashkëmoshatarët ose me autoritete, për shembull mësuesit)**

Fëmiu im mund të krijojë një marrëdhënie zyrtare me njerëzit e tjerë dhe të mbajë një marrëdhënie me ta, të tilla si mësuesit e shkollës, punëdhënësi, profesionistë ose ofruesit e shërbimeve, të tilla si mjeshtra ose shitës.

d750

**Vendosja e marrëdhënieve me miqtë, shokët e klasës, fqinjët.**

Fëmiu im mund të krijojë kontakte me bashkëmoshatarët, miqtë ose shokët e klasës. Kjo vlen, për shembull, për personat që i përkasin të njëjtit grup shoqëror, që jetojnë në të njëjtën shtëpi ose në të njëjtën lagje.

d760

**Vendosja e marrëdhënieve me anëtarët e familjes (për shembull me nënën, babain, motrat ose gjyshërit)**

Fëmiu im mund të krijojë dhe të mbajë marrëdhënie me anëtarët e familjes, siç janë prindërit ose vëllezrit dhe motrat, anëtarët e familjes së gjërë (gjyshërit, etj.), Familjet që birësojnë ose kujdesen për fëmijët e njerëzve të tjerë, dhe anëtarët e familjeve më të largëta (për shembull, kushërinj të shkallës së dytë) ose kujdestarë ligjorë.

d770

**Mardhëniet intime**

Fëmiu im (në varësi të moshës) mund të krijojë marrëdhënie intime ose lidhje dashurie me njerëzit e tjerë dhe t'i ruajë ato, për shembull me partnerin ose burrin / gruan.

d8



### **Pjesëmarrja në fusha të rëndësishme të jetës (arsim, profesion, ekonomi)**

Kjo pjesë ka të bëjë me pjesëmarrjen e fëmijës tim në aktivitete të ndryshme të nevojshme për edukimin / arsimim, punë, profesion, si dhe aktivitete për kryerjen e transaksioneve ekonomike (prodhimi dhe konsumimi i produkteve, kursimi i parave).

d810

### **Pjesëmarrja gjatë mësimit në shtëpi ose në ambiente të tjera joformale.**

Fëmiu im mund të studiojë në shtëpi ose në një hapësirë tjetër të pa strukturuar ose në një mjedis joformal. Kjo vlen, për shembull, për aktivitetet artizanale që mund të mësojë nga prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes, por gjithashtu i referohet përvetësimit të aftësive praktike dhe teorike (për shembull, përmes shkollimit në shtëpi ose privat).

d815

### **Pjesëmarrja në arsimin parashkollor (çerdhe, kopsht fëmijësh)**

Fëmiu im përdor ofertat e arsimit parashkollor që shërbejnë për t'u përgatitur për shkollë. Kjo vlen, për shembull, për kujdesin ditor (çerdhe, kopsht fëmijësh) ose oferta të studimit në shtëpi (për shembull, me kujdestar). E gjithë kjo shërben për t'i dhënë fëmijës aftësi mendore, fizike, gjuhësore dhe sociale të nevojshme për edukimin e tij të mëtuqjeshëm.

d816

### **Pjesëmarrja në aktivitete të tjera parashkollore, të tilla si shëtitje apo festa**

Fëmiu im mer pjesë në aktivitete të tjera parashkollore si: shëtitje apo festa.

d820

**Pjesëmarrja në arsimin shkollor**

Fëmiu im ka mundësinë të shkojë në shkollë dhe të ndjekë shkollimin. Kjo do të thotë që fëmija im shkon rregullisht në shkollë, punon me nxënës të tjerë, ndjek udhëzimet e mësuesit, organizon detyra dhe projekte, mëson dhe kryen detyra dhe përparon në nivelet e ardhshme të arsimit.

d825

**Arritja e trajnimit profesional**

Fëmiu im është në gjendje të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet brenda arsimit profesional dhe të zotërojë përmbajtjet e programit mësimor. Ato i nevojiten për përgatitje për profesionin e tij të ardhshëm.

d830

**Arsimimi i lartë**

Fëmiu im (sipas moshës) mund të marrë pjesë në programe të arsimit të lartë në universitete, arsim të lartë dhe shkolla profesionale. Ai mund të zotërojë përmbajtjen e synuar të programit mësimor të cilat janë të nevojshme për një provim përfundimtar ose diplomë.

d835

**Pjesëmarrja në aktivitete të tjera brenda arsimit shkollor (për shembull, kryetari i klasës)**

Fëmiu im merr pjesë në shoqata të lidhura me shkollën, të tilla si përfaqësues i shkollës ose i trupit studentor (për shembull, kryetar i klasës).

d840

**Përgatitja për punë**

Fëmiu im (në përputhshmëri me moshën) është në gjendje të marrë pjesë në të gjitha programet që përgatiten për një profesion ose profesion të veçantë, të tilla si detyra të kërkuara në profesion, praktikë, përfshirë punën praktike, si dhe trajnime dhe arsim shtesë.

d845

**Marrja, mbajtja dhe largimi nga puna**

Fëmiu im (sipas moshës) është në gjendje të kërkojë, të gjejë dhe të zgjedhë një punë ose të pranojë një ofertë pune. Është në gjendje të mbajë një punë, të përparojë, por gjithashtu, nëse është e nevojshme, të ndërpresë marrëdhëniet e punës në një mënyrë të përshtatshme.

d850

**Punë e paguar (punësim)**

Fëmiu im (sipas moshës) është në gjendje të mbajë një punë të paguar, siç është një profesion, një veprimtari tregtare ose biznesi, si një individ privat ose një punë tjetër me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Kjo do të thotë që fëmija im është në gjendje të kërkojë një punë, të mbajë punën, të përmbushë detyrat e kërkuara (vetëm ose në një grup), të vijë të punojë në kohë, të ketë një funksion menaxherial ose kontrolli në punë.

d855

**Puna e papaguar (vullnetare)**

Fëmiu im (sipas moshës) gjithashtu merr pjesë në detyra me orar të plotë ose me kohë të pjesshme për të cilat nuk i sigurohet pagesa. Kjo vlen, për shembull, për punën vullnetare për komunitetin, grupet fetare ose ndihmën në lagje.

d860

**Transaksionet themelore ekonomike (marrëveshjet)**

Fëmiu im (në varësi të moshës) është në gjendje të marrë pjesë në çdo formë të marrëdhënieve të thjeshta ekonomike, siç është përdorimi i parave kur blen sende ushqimore, shkëmbimi i produkteve dhe shërbimeve, ose kursimi i parave.

d865

**Transaksione komplekse ekonomike (marrëveshje)**

Fëmiu im (në varësi të moshës) është në gjendje të marrë pjesë në çdo formë të transaksioneve (marrëveshjeve) komplekse ekonomike. Kjo përfshin, për shembull, menaxhimin me llogarinë e tij bankare ose tregtimin e produkteve.

d870

**Menaxhimi me pasuritë e veta ekonomike (para dhe mallra të tjera)**

Fëmiu im është në gjendje të menaxhojë me të mirat e tij materiale.

d880

**Loja**

Fëmiu im angazhohet me qëllim dhe gjatë një periudhe të caktuar kohore me objekte, lodra ose lojëra. Kjo mund të vlejë kur fëmija po luan vetëm, kur fëmija po shikon fëmijë të tjerë duke luajtur, kur është duke luajtur pranë fëmijëve të tjerë ose kur është duke luajtur bashkë me fëmijë të tjerë.

d9 **Pjesëmarrja në komunitet, shoqëri dhe jetën civile.**

Kjo pjesë ka të bëjë me atë se si ne marrim pjesë në jetën e përbashkët, shoqërore (jashtë familjes tonë). Kjo mund të përfshijë pjesëmarrje në organizata të ndryshme, pjesëmarrje në sport dhe aktivitete sportive, pjesëmarrje në ngjarje të ndryshme kulturore ose pjesëmarrje në zona të tjera sociale dhe qytetare, siç është praktikimi i fesë ose pjesëmarrja në zgjedhje.

d910

**Pjesëmarrje në komunitet (për shembull, në shoqata)**

Fëmiu im merr pjesë (në varësi të moshës së tij) në të gjitha fushat e jetës shoqërore në komunitet. Mund të jetë, për shembull, pjesëmarrje në organizata vullnetare, joqeveritare, shoqata sportive, Kryqi i Kuq / Gjysmëhëna e Kuqe, organizata sociale profesionale ose të tjera.

d920

**Pjesëmarrje në aktivitete rekreative dhe pushim**

Fëmiu im është në gjendje të marrë pjesë në të gjitha format e lojërave, aktiviteteve të kohës së lirë ose aktivitete rekreative dhe relaksuese. Kjo vlen, për shembull, për lojëra ose sporte, programe fitnesi, relaksim dhe argëtim. Fëmija im mund të shkojë në kinema ose teatër, të vizitojë ekspozita arti ose muze. Për shembull, në kohën e lirë, ai mund të bëjë vepra artizanale, të praktikojë hobi, të lexojë për t'u çlodhur, të luajë instrument, të shikojë monumente historike ose të udhëtojë.

d930

**Pjesëmarrja në aktivitete fetare dhe shpirtërore**

Fëmiu im është në gjendje të marrë pjesë në aktivitete fetare dhe shpirtërore ose t'i përkasë organizatave dhe grupeve në mënyrë që të vetë-përmbushet, të gjejë kuptim në jetë ose të krijojë një marrëdhënie me një hyjni. Mund të marrë pjesë në aktivitetet fetare të një kisha, tempulli, xhamie ose sinagogu, të këndojë dhe të lutet për arsye fetare.

d940

**Gëzon të drejtat e njeriut**


Fëmiu im gëzon të gjitha të drejtat ndërkombëtare që ka një fëmijë, një njeri ose një person me aftësi të kufizuara (pengesa në zhvillim).

d950

**Pjesëmarrja në jetën politike dhe qytetare**

Fëmiu im (sipas moshës së tij) merr pjesë në jetën shoqërore, politike dhe qytetare. Ai ka të gjitha të drejtat si qytetar, si dhe të drejtat që lidhen me të.





e

**Faktorët e mjedisit**

Faktorët e rrethinës

e1

**Produkte, pajisje dhe ndihmesa teknike (për të parandaluar, zvogëluar ose kompensuar paaftësinë)**

Kjo pjesë flet për të gjitha produktet, pajisjet dhe ndihmat teknike që natyra u ka dhënë ose i ka bërë njeriu, dhe gjenden në afërsi të fëmijës tim (për shembull, në ushqim ose ilaç). Kjo vlen edhe për pajisjet e tjera dhe ndihmat teknike (për shembull, një rul ose një krevat të lëvizshëm). Kjo i referohet posaçërisht produkteve, pajisjeve dhe ndihmave teknike që mund të përdoren nga personat me aftësi të kufizuara për të parandaluar, zvogëluar ose kompensuar aftësinë e kufizuar.

e110

**Produkte të përditshme për përdorim personal (ushqim, pije dhe ilaçe)**

Ka mjaft produkte në mjedisin e fëmijës tim që ai përdor çdo ditë, të tilla mund të jenë ushqim, pije dhe barna. Ato mund të jenë natyrale ose të prodhohen nga njerëzit.

e115

**Pajisjet, produktet dhe teknologjitë për përdorim personal në jetën e përditshme (veshje, mobilje, takëm ushqimi, gota, etj.)**

Ka mjaft vegla të përditshme përreth fëmijës tim, siç janë rrobat, mobiljet, lugët, pirunët, gotat, shishet e pirjes, lodrat, si dhe protezat e aparate tjera të ngjashme.

**e120****Pajisjet lëvizëse (rul, karrige me rrota, biçikletë terapeutike, dubak, skuter, biçikletë me tri rrota, skejtbord, proteza ose produkte tjera transportuese)**

Ka pajisje, produkte dhe teknologji të mjaftueshme përreth fëmijës tim që e ndihmojnë atë të lëvizë brenda dhe jashtë. Mund të jetë një rul, karrige me rrota, biçikletë terapeutike, dubak, skuter, biçikletë me tri rrota, skejtbord, proteza.

**e125****Mjetet e komunikimit, siç janë telefoni, telefoni celular, aparatet e dëgjimit, etj.**

Fëmija im ka qasje në burimet përreth tij që e ndihmojnë atë të komunikojë, ato mund të janë: telefoni, telefoni celular, aparati i dëgjimit dhe paistje tjera të ngjashme.

**e130****Materialet për mësim (libra me figura, enigma me bashkim figurash)**

Fëmija im ka paisje dhe teknologji në mjedisin e tij, si libra me figura, libra shkollorë ose enigma që e ndihmojnë atë të mësojë, të fitojë njohuri, të aftësohet dhe t'i përdorë ato në edukimin e tij.

**e135****Mjetet dhe veglat për punë**

Fëmija im (varësisht nga mosha) posedon vegla dhe teknologji në mjedisin e tij (për shembull, programe kompjuterike) të cilat ia mundësojnë kryerjen e detyrave të ndryshme

**e140****Produktet dhe teknologjia për kulturë, rekreacion dhe sport, si top futbollit, tavolinë për pingpong dhe të ngjashme**

Fëmija im ka objekte, pajisje dhe teknologji në mjedisin e tij që e ndihmojnë atë të marrë pjesë në aktivitete kulturore dhe sportive.

**e145****Mjete për praktikimin e fesë dhe gjendjes shpirtërore**

Fëmija im në rrethin e tij ka mjaft objekte që lidhen ngusht me fenë dhe spiritualitetin. Të tilla janë Bibla, Kurani, sexhadeja për lutje, etj)

**e150**

**Qasja në ndërtesat publike (ashensorët, udhëpërshkrues në letrën e Brailit)**

Ndërtesat publike përreth fëmijës tim janë ndërtuar në atë mënyrë që të mos e pengojnë lëvizjen e tij të lirë ose të përreth tij ka teknologji të ndryshme si ashensorë, dyer elektrike ose udhëpërshkrues në shkrim Brail të cilat mundësojnë atij të lëvizë pa hasur në pengesa.

**e155**

**Tualet për personat me aftësi të kufizuara**

Nuk ka pengesa në shtëpinë e fëmijës tim për kryerjen e nevojave personale, gjegjësisht, ekzistojnë teknologji që e lejojnë atë të lëvizë lirshëm (për shembull, ekziston tualet për njerëz me aftësi të kufizuara, shkallë elektrike, etj.

**e160**

**Qasja në hapësirë (për shembull, qasja në kënde lojërash)**

Hapësira jashtë shtëpisë (për shembull, një shesh lojërash) është ndërtuar pa pengesa ose ka teknologji që lejojnë fëmijën tim të lëvizë lirshëm.

**e165**

**Paratë dhe të ardhurat jetësore**

Fëmija im jeton në një mjedis që ka burime të mjaftueshme materiale, të tilla si para, pronë, mallra.

e2



### Kushtet e mjedisit jetësorë

Ky kapitull trajton pjesët e gjalla dhe jo të gjalla të mjedisit. Këtu flasim për natyrën, por edhe për mjedisin që njeriu rregullon vetë (për shembull: rrugë, ura, shtëpi, gjelbërim). Kjo gjithashtu i referohet numrit të banorëve në afërsi të fëmijës tim.

e210

### Natyra (malet, lumenjtë)

Mjedisi në të cilin jeton fëmija im ka veçori të shumta. Këto janë, për shembull, malet ose hapësirat ujore. Këto tipare mund të jenë lehtësim ose pengesë për fëmijën tim.

e215

### Njerëzit me të cilët jetojmë në mjedisin tonë

Fëmija im jeton në një grup nacional (për shembull: pakicë kombëtare, migrantë). Këto kushte jetese mund të jenë lehtësim ose barrierë për fëmijën tim.

e220

### Bimët dhe kafshët

Fëmija im jeton në një mjedis ku ka kafshë dhe bimë. Të njëjtat mund të jenë të dobishme ose pengesë për fëmijën tim.

e225

### Koha dhe kushtet klimatike

Kjo pjesë përfshin temperaturën, lagështinë, presionin e ajrit, reshjet, erën dhe ndryshimet sezonale, ndaj të cilave fëmija im ekspozohet. Këto kushte mund të jenë lehtësim ose pengesë për fëmijën tim.

e230

**Mbrojtja nga katastrofat natyrore**

Kjo ka të bëjë me atë nëse fëmija im është mjaftueshëm i mbrojtur nga fatkeqësitë natyrore, ndaj të cilave fëmija ekspozohet herë pas here. Këto fatkeqësi (siç janë tërmetet, zjarret, përmytjet, erërat e forta) mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme për mjedisin dhe për fëmijën tim. Këto kushte mund të jenë lehtësim ose pengesë për të.

e235

**Mbrojtja nga ngjarjet e shkaktuara nga njeriu (luftëra dhe konflikte)**

Kjo vlen për kushtet e mjedisit në të cilin jeton fëmija im, të cilat e mbrojnë atë nga konflikti, lufta, persekutimi, shkatërrimi i shtëpive, tokës ose infrastrukturës, zhvendosjes. Këto kushte mund të jenë lehtësim ose pengesë për fëmijën tim.

e240

**Dritë dhe ndriçim**

Kjo pjesë flet për ndriçimin e mjedisit në të cilin jeton fëmija im. Ndriçim ky i cili mund të jetë nga dielli (dritë natyrore) ose drita artificiale (qirinj, vaj llambash ose llamba me parafine, zjarri ose energjia elektrike). Këto kushte mund të jenë lehtësim ose pengesë për fëmijën tim.

e245

**Dita/nata dhe fazat e hënës**

Kjo i referohet nëse jeta e fëmijës tim përcaktohet nga ndryshimet natyrore, të rregullta ose të parashikueshme të motit, siç janë ndryshimet në ditë ose natë ose fazat e hënës. Këto kushte mund të jenë lehtësim ose pengesë për fëmijën tim.

e250

**Zëri dhe ushtima**

Kjo i referohet tingujve ose zhurmës që fëmija im dëgjon në mjedisin e tij. Tingujt që ai dëgjon mund të jenë lehtësim ose pengesë për fëmijën tim.

**e255****Dridhje (nga shpërthimet, aeroplanët) etj.**

Kjo i referohet nëse fëmija im i nënshtrohet prerjeve të rregullta ose të parregullta, tronditjeve ose lëkundjeve të sendeve, ndërtesave ose njerëzve. Mund të jetë vibrim nga aeroplanët ose nga shpërthimet. Këto kushte mund të jenë lehtësim ose pengesë për fëmijën tim.

**e260****Ajri i pastër**

Kjo i referohet pyetjes se si është ajri në mjedisin në të cilin jeton fëmija im. Bëhet fjalë për ajrin brenda dhe jashtë, në qiell të hapur. Këto kushte mund të jenë lehtësim ose pengesë për fëmijën tim.

e3



### **Mbështetje nga njerëz të rëndësishëm dhe marrëdhëniet me ta**

Kjo pjesë merret me ndikimin njerëzve ose kafshëve që ndodhen përreth fëmijës tim dhe mbështetjen që ata e ofrojnë. Kjo mbështetje mund të jetë fizike (për shembull, mbajtja e një fëmije) ose emocionale (për shembull, duke ia mundësuar rehatinë). Kjo përfshin mbrojtje, ndihmë dhe marrëdhënie me njerëz, fëmijë, fqinjë, mësues ose profesionistë.

e310

### **Mbështetje nga anëtarët e afërt të familjes (nëna, babai, motra, vëllai, gjyshja, gjyshi, prindi birësues)**

Kjo shtron pyetjen nëse fëmija im merr mbështetje nga familjen e tij e ngushtë dhe cila është ajo mbështetje. Familja më e ngushtë përfshin prindërit, motrat, vëllezërit, gjyshërit, prindërit kujdestarë ose prindërit birësues. Nëse ka mbështetje nga këta anëtarë, mund të jetë një lehtësim për fëmijën, por nëse ai nuk e ka këtë mbështetje, mund të jetë një pengesë e madhe për të.

e315

### **Mbështetje nga familja e gjërë (tezja, halla, xhaxhai, daja, kushërinjtë etj.)**

Kjo shtron pyetjen nëse fëmija im merr mbështetje nga familjen e tij e zgjeruar dhe cila është kjo mbështetje. Familja e zgjeruar përbëhet nga xhaxhai, tezja, halla dhe daja, nga kushërinjtë. Nëse ka mbështetje nga këta anëtarë, mund të jetë një lehtësim për fëmijën, por në mungesë të kësaj mbështetjeje fëmija im mund të hasë në vështirësi.

e320

### **Mbështetja nga miqtë**

Kjo i referohet pyetjes nëse fëmija im ka miq, nëse ai merr mbështetje nga ata dhe sa është kjo mbështetje. Nëse kjo mbështetje egziston, kjo nënkupton një lehtësim për fëmijën tim, por në rast se kjo mbështetje mungon, atëherë ai mund të hasë në vështirësi.



e325

**Mbështetje nga të njohurit, bashkëmoshatarët, kolegët, fqinjët etj.**

Kjo i referohet pyetjes nëse fëmija im merr mbështetje dhe ndihmë nga të njohurit, bashkëmoshatarët dhe fqinjët, nëse ata kujdesen për të dhe e mbrojnë atë, dhe sa e madhe mund të jetë është kjo mbështetje. Nëse ka mbështetje nga ky grup njerëzish, mund të jetë një lehtësim për fëmijën, mirëpo nëse kjo mbështetje mungon fëmija mund të hasë në vështirësi.

e330

**Mbështetje nga njerëzit me autoritet dhe në pozita të ndryshme (mësues, edukatorë)**

Kjo shtron pyetjen nëse ata njerëz që janë të ndikuar nga autoritetet - vartësit - janë në dispozicion të fëmijës tim dhe se si ata e mbështesin fëmijën tim. Vartësit, në varësi të moshës së fëmijës, mund të jenë studentë, punëtorë, anëtarë të një grupi fetar dhe të ngjashme. Nëse ka mbështetje nga ky grup njerëzish, mund të jetë një lehtësim për fëmijën, ndërsa mos mbështetja e tyre mund të jetë pengesë për të.

e335

**Mbështetje nga vartësit**

Kjo shtron pyetjen nëse ata njerëz që janë të ndikuar nga autoritetet - vartësit - janë në dispozicion të fëmijës tim dhe se si ata e mbështesin fëmijën tim. Vartësit, në varësi të moshës së fëmijës, mund të jenë studentë, punëtorë, anëtarë të një grupi fetar dhe të ngjashme. Nëse ka mbështetje nga ky grup njerëzish, mund të jetë një lehtësim për fëmijën, ndërsa mos mbështetja e tyre mund të jetë pengesë për të.

e340

**Mbështetje nga kujdestarët, asistentët, asistentët personal ose ndihmësit e tjerë**

Kjo vlen për pyetjen nëse fëmija im ka qasje në kujdestarë, asistentë, asistentë personalë dhe ndihmës të tjerë dhe sa mbështetje, mbrojtje dhe kujdes i japin ata. Nëse ka mbështetje nga ky grup njerëzish, mund të jetë një lehtësim për fëmijën, por mosmbështetja nga ata mund të jetë një pengesë për fëmijën.

**e345****Mbështja nga njerëz të panjohur**

Kjo i referohet pyetjes nëse të huajt që e njohin situatën e jetës së fëmijës tim, siç janë kujdestarët ose mësuesit zëvendësues, bashkëpunëtorët, etj., Janë në dispozicion të tij dhe i japin ndihmë dhe mbështetje. Nëse ka njerëz të tillë, mbështetja e tyre mund të jetë një lehtësim për fëmijën, por nëse ata nuk e kanë këtë mbështetje, mund të jetë një pengesë për fëmijën.

**e350****Ndihmë nga ana e kafshëve shtëpiake**

Kjo i referohet pyetjes nëse fëmija im ka një kafshë shtëpiake (qen, mace, peshk, zog, etj.) që mund të sigurojë mbështetje emocionale ose psikologjike ose mund ta ndihmojë atë të lëvizë lirshëm. Nëse në shtëpinë e fëmiut tim ka kafshë shtëpiake, mbështetja e tyre mund të jetë një lehtësim për të, dhe anasjelltas, nëse nuk ka kafshë shtëpiake mund të shfaqet ndonjë vështirësi për fëmijën.

**e355****Mbështetje nga mjekët, terapistët dhe profesionistët e tjerë të shëndetit**

Kjo i referohet pyetjes nëse fëmija im ka qasje te mjekët apo terapistët dhe sa mbështetje, ndihmë apo kujdes ai merr prej tyre. Nëse fëmija im ka qasje te mjekët, terapistët dhe profesionistët e tjerë të shëndetit, mbështetja e tyre mund të jetë një lehtësim për fëmijën, por nëse këta njerëz nuk janë të disponueshëm për fëmijën tim, atëherë kjo mund të jetë një pengesë për të.

**e360****Mbështetje nga punonjësit socialë, avokatët dhe profesionistët e tjerë**

Kjo i referohet pyetjes nëse fëmija im ka akses në mbështetje, ndihmë apo kujdes nga profesionistë të tjerë si: punonjës socialë, person juridik, avokat dhe të ngjashme dhe sa është kjo mbështetje. Nëse fëmija im ka mbështetjen e këtyre profesionistëve, mund të jetë një lehtësim, por nëse këta njerëz nuk janë të disponueshëm për fëmijën tim, atëherë kjo mund të jetë një pengesë për të.

e4 **Qëndrimet (mendimet) e njerëzve të rëndësishëm**

Kjo pjesë trajton qëndrimet (perceptimet dhe mendimet) e njerëzve që janë të afërt dhe të rëndësishëm për fëmijën tim. Këto qëndrime luajnë një rol të rëndësishëm në mënyrën se si fëmija im ndihet dhe në vetëbesimin e tij. Kjo kryesisht i referohet mesazheve të dërguara nga njerëz të tjerë të afërt me fëmijën tim (prindërit, motrat dhe vëllezërit, profesionistët) dhe gjithashtu i referohet perceptimeve të rrethit (për shembull, qëndrimet ndaj personave me aftësi të kufizuara). Qëndrime të tilla ndaj fëmijës tim mund të jenë lehtësim ose pengesë për të.

## e410

**Qëndrimet dhe mendimet e anëtarëve të familjes së ngushtë (prindërit, motrat, vëllezërit, gjyshërit, prindërit kujdestarë ...)**

Anëtarët e familjes së ngushtë (nëna, babai, motra, vëllai, fëmija i birësuar, etj.) kanë mendime dhe pikëpamje të ndryshme për fëmijën tim. Këto qëndrime zakonisht ndikojnë në mënyrën sesi ata trajtojnë fëmijën tim. Qëndrimet e tyre (shqetësimet, dëshirat, pritjet) mund të kenë efekte pozitive ose negative tek fëmija im.

## e415

**Qëndrimet dhe mendimet e anëtarëve të familjes më të gjerë (xhaxhai, teza, halla, daja kushërinjtë ...)**

Anëtarët e familjes së gjërë (teza, xhaxhai, daja, halla, kushërinjtë etj.) kanë mendimet dhe pikëpamjet e tyre për fëmijën tim. Këto qëndrime zakonisht ndikojnë në mënyrën sesi ata trajtojnë fëmijën tim. Qëndrimet e tyre (shqetësimet, dëshirat, pritjet) mund të kenë efekte pozitive ose negative tek fëmija im.

e420

**Pikëpamjet dhe mendimet e miqve**

Miqtë kanë mendimin dhe qëndrimet e tyre ndaj fëmijës tim. Këto qëndrime zakonisht ndikojnë në mënyrën sesi ata trajtojnë fëmijën tim dhe veprimet e tyre. Qëndrimet e tyre (shqetësimet, dëshirat, pritjet) mund të kenë efekte pozitive ose negative tek fëmija im.

e425

**Mendimet dhe qëndrimet e bashkëmoshatarëve, kolegëve, fqinjëve etj.**

Bashkëmoshatarët, kolegët, fqinjët kanë mendimet dhe pikëpamjet e tyre për fëmijën tim. Këto qëndrime zakonisht ndikojnë në mënyrën sesi ata trajtojnë fëmijën tim. Qëndrimet e tyre (shqetësimet, dëshirat, pritjet) mund të kenë efekte pozitive ose negative tek fëmija im.

e430

**Qëndrimet dhe mendimet e njerëzve me autoritet dhe njerëzve në pozita (mësues, arsimtarë)**

Njerëzit që kanë autoritet mbi fëmijën tim (për shembull, mësuesit, arsimtarët, udhëheqësit fetarë) kanë mendimet dhe qëndrimet e tyre për fëmijën tim. Këto qëndrime zakonisht ndikojnë në mënyrën sesi ata trajtojnë fëmijën tim. Qëndrimet e tyre (shqetësimet, dëshirat, pritjet) mund të kenë efekte pozitive ose negative tek fëmija im.

e435

**Mendimet e vartësve**

Njerëzit që janë në një rol vartës në lidhje me fëmijën tim (nëse kjo vlen për fëmijën tim dhe në varësi të moshës së tij) kanë mendimin dhe qëndrimet e tyre ndaj fëmijës tim. Këto qëndrime zakonisht ndikojnë në mënyrën sesi ata trajtojnë fëmijën tim. Qëndrimet e tyre (shqetësimet, dëshirat, pritjet) mund të kenë efekte pozitive ose negative tek fëmija im.

**e440****Qëndrimet dhe mendimet e kujdestarëve, ndihmësve, ndihmësve personalë ose ndihmësve të tjerë**

Asistentët personalë, kujdestarët, ndihmësit rreth fëmijës tim kanë mendimet dhe pikëpamjet e tyre për fëmijën tim. Këto qëndrime zakonisht ndikojnë në mënyrën sesi ata trajtojnë fëmijën tim. Këto qëndrime (shqetësime, dëshira, pritje) mund të kenë efekte pozitive ose negative tek fëmija im.

**e445****Qëndrimet dhe mendimet e njerëzve të huaj**

Njerëzit e panjohur rreth fëmijës tim kanë mendimet dhe qëndrimet e tyre për fëmijën tim. Këto qëndrime zakonisht ndikojnë në mënyrën sesi ata trajtojnë fëmijën tim. Këto qëndrime (shqetësime, dëshira, pritje) mund të kenë efekte pozitive ose negative tek fëmija im.

**e450****Mendimet dhe qëndrimet e mjekëve, terapistëve dhe profesionistëve të tjerë të shëndetit**

Mjekët, terapistët dhe profesionistët e tjerë të shëndetit kanë mendimet dhe pikëpamjet e tyre për fëmijën tim. Këto qëndrime zakonisht ndikojnë në mënyrën sesi ata trajtojnë fëmijën tim. Këto qëndrime (shqetësime, dëshira, pritje) mund të kenë efekte pozitive ose negative tek fëmija im.

**e455****Qëndrimet dhe mendimet e punonjësve socialë, personave juridik dhe profesionistëve të tjerë.**

Punonjësit socialë, avokatët dhe profesionistët e tjerë rreth fëmijës tim kanë mendimet dhe pikëpamjet e tyre për fëmijën tim. Këto qëndrime zakonisht ndikojnë në mënyrën sesi ata trajtojnë fëmijën tim dhe veprimet e tyre. Këto qëndrime (shqetësime, dëshira, pritje) mund të kenë efekte pozitive ose negative tek fëmija im.

e460

### **Qëndrimet dhe mendimet e shoqërisë**

Mjedisi në të cilin jeton fëmija im ndikohet nga mendimet dhe qëndrimet e njerëzve që jetojnë në të. Këto qëndrime të zakonshme ndikojnë në sjelljen dhe veprimet e individëve ose grupeve ndaj fëmijës tim. Këto qëndrime (shqetësime, ndjenja, dëshira, pritje) mund të kenë efekte pozitive ose negative tek fëmija im.

e465

### **Normat shoqërore, praktikat dhe ideologjitë**

Në mjedisin ku jeton fëmija im, ekzistojnë disa rregulla, praktika, besime dhe pikëpamje të gjërave. Ato kanë ndikim tek fëmija im, i cili mund të jetë negativ ose pozitiv.

### **Disponueshmëria e shërbimeve, sistemeve dhe politikave (p.sh. sistemet shëndetësore, sistemet sociale), si dhe menaxhimi dhe kontrolli i tyre**

Ky seksion konsideron: 1. Shërbime të ndryshme (sigurime shëndetësore, spitale, shkolla, etj.). Ai i referohet shërbimeve dhe aktiviteteve në fusha të ndryshme që mbulojnë nevojat e njerëzve, siç janë kujdesi shëndetësor, sigurimet shoqërore, etj. Këto shërbime mund të jenë publike (për shembull, shkolla), private ose vullnetare. Këto shërbime mund të ofrohen në vend, d.m.th. nivel komunal, rajonal, shtetëror ose ndërkombëtar.

Shërbimet mund të ofrohen nga individë (p.sh. mjekë), shoqata, organizata, agjensi (siç është Agjencia për Punësim) ose Qeveria. Shërbimet e ofruara mund të jenë me karakter të përgjithshëm ose të përshtaten për nevojat e fëmijës. Ky seksion gjithashtu trajton: 2. Sistemet e përfshira në menaxhimin ose organizimin e shërbimeve (për shembull, zyrat rajonale). Këto sisteme kontrolli mund të vendosen nga qeveria në nivele të ndryshme. Qëllimi i tyre është të organizojnë, kontrollojnë dhe menaxhojnë shërbimet dhe mbështesin aktivitetet e ofruara.

Në këtë pjesë flasim për: 3. Politikat (parimet, udhëzimet) e funksionimit. Ato zakonisht përbëhen nga rregulla, rregullore dhe standarde të përcaktuara nga qeveria në nivele të ndryshme. Këto rregulla dhe rregullore rregullojnë dhe sistemojnë qeverisjen.

**e510****Shërbime, sisteme dhe politika për prodhimin e mallrave (fabrika për prodhimin e ushqimit dhe ilaçeve)**

Ekzistojnë shërbime, sisteme dhe politika rreth fëmijës tim që ofrojnë mjaftueshëm produkte (të tilla si karburant, ushqim, ilaç). Kjo lejon që fëmija im të konsumojë dhe të përdorë këto produkte. Prania e këtyre shërbimeve, sistemeve dhe politikave mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim, dhe mungesa e tyre mund të jetë një pengesë për të.

**e515****Shërbime, sisteme dhe politika të planifikimit urban**

Në mjedisin e fëmijës tim ka shërbime ( ndërtimtari dhe arkitekturë ), sisteme (për shembull: ligje ndërtimi) dhe politika (siç është akses) që janë përgjegjës për hartimin dhe ndërtimin e ndërtesave publike dhe private. Prania e këtyre shërbimeve, sistemeve dhe politikave mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim, dhe mungesa e tyre mund të jetë një pengesë për të.

**e520****Shërbimet, sistemet dhe parimet për planifikimin e hapësirës së lirë**

Në mjedisin e fëmijës tim ka shërbime, sisteme (për shembull: plani i përdorimit të tokës) dhe politikave për planifikimin, hartimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (p.sh. parqe, pyje, brigje, ligatinat) dhe tokë private në zonat rurale; zonat periferike dhe urbane. Prania e këtyre shërbimeve, sistemeve dhe politikave mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim, dhe mungesa e tyre mund të jetë një pengesë për të.



e525

**Shërbimet, sistemet dhe parimet për strehim**

Në mjedisin e fëmijës tim, ka shërbime, sisteme (siç janë strehimi social) dhe politika (mbrojtja e qiramarrësit) për të siguruar strehim. Prania e këtyre shërbimeve, sistemeve dhe politikave mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim, dhe mungesa e tyre mund të jetë një pengesë për të.

e530

**Shërbime, sisteme dhe politika për shërbimet komunale (ujë, energji elektrike, ngrohje ...)**

Ka shërbime dhe rregullore për shërbimet publike rreth fëmijës tim, të tilla si uji, ngrohja, energjia elektrike, deponimi i mbeturinave, transporti publik dhe shërbime të tjera të nevojshme. Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

e535

**Shërbime, sisteme dhe politika komunikimi (internet, telefon)**

Në afërsi të fëmijës tim ka shërbime, institucione publike dhe rregullore ligjore për transferimin dhe shkëmbimin e informacionit (p.sh. telefon, telefon celular, faks, postë elektronike). Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

e540

**Shërbime, sisteme dhe politika transporti (tren, autobus, taksi, aeroplan)**

Ka shërbime (transport publik) dhe rregulla për transportimin e njerëzve dhe mallrave nga një vend në tjetrin rreth fëmijës tim (si treni, autobusi, aeroplani, taksi). Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

**e545****Shërbime, sisteme dhe politika për mbrojtjen e njerëzve dhe pronave (p.sh. policia)**

Në afërsi të fëmijës tim ka shërbime (polici), institucione publike dhe rregullore ligjore për mbrojtjen e njerëzve dhe pronave (policia, kadastra, etj.). Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

**e550****Shërbimet juridike, sistemet dhe politikat (p.sh. gjykatat)**

Në afërsi të fëmijës tim ka shërbime që ofrojnë shërbime juridike (gjykata, avokatë, noterë), sisteme dhe politika (ligje, rregullore, konventa) që ofrojnë mbrojtje juridike dhe administrim të drejtësisë. Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

**e555****Anëtarësimi në organizata dhe shoqata**

Në mjedisin e fëmijës tim, ka shërbime dhe politika që lejojnë njerëzit me interes të ngjashëm të mblidhen në një organizatë. Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

**e560****Shërbime, sisteme dhe politika për informacionin publik (televizion, radio, internet)**

Ekzistojnë shërbime (transmetues të ndryshëm), sisteme transmetuese dhe rregulla për sigurimin dhe përdorimin e komunikimit masiv përmes radio, televizionit, gazetave dhe internetit në mjedisin e fëmijës tim. Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

**e565****Shërbimet, sistemet dhe politikat ekonomike - veprimtaritë e shërbimit**

Në mjedisin e fëmijës tim ka shërbime dhe sisteme për prodhimin, shpërndarjen, konsumin ose përdorimin e mallrave dhe shërbimeve. Ato mund të sigurohen nga individë privatë (kasapë, parukierë, etj.), Sektori publik (për shembull: kooperativa) ose organizata financiare siç janë bankat dhe kompanitë e sigurimeve. Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

**e570****Shërbime, sisteme dhe politika të sigurimeve shoqërore**

Ka shërbime rreth fëmijës tim (si agjencioni për punësimi), sisteme (p.sh., e drejta për përfitime të papunësisë) dhe politika për të mbështetur njerëzit financiarisht. Kjo mbështetje u jepet njerëzve që, varësisht nga mosha e tyre, gjendja e dobët financiare, papunësia, problemet shëndetësore ose paaftësia, varen nga mbështetja e shtetit. Ky kompensim mund të jetë nga taksat ose kontributet (p.sh. sigurimi shëndetësor, sigurimi pensional). Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

**e575****Shërbime, sisteme dhe parime të ndihmës sociale (përkujdesje, ndihmë shtëpiake, etj.)**

Në mjedisin e fëmijës tim ka shërbime, sisteme dhe rregulla për njerëzit që kanë nevojë për ndihmë në jetën e përditshme. Kjo mund të jetë e dobishme në blerjen e gjërave të përditshme, mirëmbajtjen e një shtëpie, kujdesin për fëmijët, vetë-kujdesin dhe kujdesin për të tjerët. Kjo lejon që këta njerëz të marrin pjesë sa më shumë që të jetë e mundur në jetën shoqërore (për shembull, përmes ndihmës sociale, ndihmës shtëpiake, ndihmë financiare për familjen, asistencës pedagogjike sociale për familjen). Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

**e580****Shërbime shëndetësore, sisteme dhe politika (spitale, klinika dhe institucione të tjera shëndetësore)**

Në mjedisin e fëmijës tim, ka shërbime, sisteme dhe politika për të parandaluar dhe trajtuar problemet shëndetësore. Kjo përfshin rehabilitimin mjekësor dhe mbështetjen për një mënyrë jetese të shëndetshme. Kjo mund të bëhet, për shembull, në një spital, në një pediatër ose në një klinikë. Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

**e585****Shërbime, sisteme dhe politika për arsimin dhe aftësimin (kopshte, shkolla, kurse, praktikë)**

Ekzistojnë shërbime, sisteme dhe politika rreth fëmijës tim që lejojnë që fëmija im të arsimohet ose të aftësohet. Kjo i referohet arsimin dhe aftësimin në kopshte, shkolla, qendra trajnimi, shkolla speciale, mentorim, kurse, etj. Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

e590

**Shërbimet e punësimit, sistemet dhe politikat (agjencitë e punësimit, qendrat parakualifikuese)**

Ekzistojnë shërbime, sisteme dhe politika rreth fëmijës tim që lejojnë njerëzit që janë të papunë ose që duan të ndryshojnë vendin e punës për të gjetur punë një punë më të mirë. Kjo përfshin shërbime për njerëzit që duan të përparojnë në karrierën e tyre. Pjesëmarrja në këto shërbime, sisteme dhe politika mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për të.

e595

**Shërbimet politike dhe sistemet politike (qeveria dhe organet zgjedhore)**

Në mjedisin e fëmijës tim ( në varësi të moshës së tij), ka shërbime, sisteme dhe politika që lejojnë zgjedhjet dhe qeverisjen e vendeve, bashkive, rajoneve, organizatave ndërkombëtare. Prania e këtyre shërbimeve dhe sistemeve mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë.

e598

**Shërbime, sisteme dhe politika, të përcaktuara ndryshe - shërbime interdisiplinore (Qendrat për zhvillim dhe mbështetje të hershme, Qendrat për shërbime dhe mbështetje të ndryshme)**

Në mjedisin e fëmijës tim ka shërbime që në bashkëpunim të ngushtë me njëri-tjetrin (si qendra interdisiplinore për zhvillimin dhe përkrahjen e hershme), mbështesin dhe ndihmojnë fëmijët me probleme zhvillimi si dhe familjet e tyre, dhe kontribuojnë në zhvillimin e fëmijëve. Pjesëmarrja në këto shërbime mund të jetë një lehtësim për fëmijën tim. Mungesa e tyre mund të jetë pengesë për ta.

### 3. Literatura

Organizata Botërore e shëndetsisë (2017).  
Klasifikimi Ndërkombëtar i funksionimit, pengesës dhe shëndetit UNICEF,  
përkthim.  
Shkup: UNICEF

Weltgesundheitsorganisation (2011).  
*ICF-CY. Internationale Klassifikation der Funktionsfähigkeit, Behinderung  
und Gesundheit.*  
Bern: Huber

Pretis, M. (2016).  
*ICF-basiertes Arbeiten in der Frühförderung.*  
München: Reinhardt

Pretis, M., Kopp-Sixt, S. Mechtl, R. (2019).  
*ICF-basiertes Arbeiten in der inklusiven Schule.*  
München: Reinhardt



## 4. Projekti dhe partneri

"Gjuha e përbashkët në shkollë" ( [www.icf-school.eu](http://www.icf-school.eu)) është projekt i financuar nga programi ERASMUS +i EU. projekti zgjatë prej 01.09.2018 deri më 31.08.2021 dhe është implementuar nga ana e 10 bashkëpunëtorëve në vijim:



Bildungsdirektion Steiermark,  
Austria



Association of Child Development and  
Educators – CDGER  
Turkey



Down Syndrome Association,  
Turkey



DI Wilhelm Stadler  
InfoPro,  
Austria



MSH  
Medical School Hamburg,  
Germany



Здружение „Образование за сите“  
Скопје,  
Северна Македонија



Основно училиште „Ванчо Прке“  
Штип,  
Северна Македонија



University College of  
**Teacher Education**  
Styria

Pädagogische Hochschule Steiermark,  
Austria



Pfennigparade Phoenix  
Schulen und Kitas GmbH,  
Germany



Dr. Pretis  
S.I.N.N. Evaluation (Koordinator)  
Graz, Austria



Unterstützungsverein  
Schulpsychologie,  
Austria

With the support of the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union







## KNF në gjuhë të kuptueshme për familjen

Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, pengesës dhe shëndetit – KNF - ja, e publikuar nga organizata botërore e shëndetësisë në vitin 2001 (zyrtarisht e përkthyer në gjuhën maqedonase në 2017) paraqet standard të pranuar në nivel botëror me ndihmën e të cilit mund të përshkruhet situata e një fëmiju, të riu ose të rrituri me problem shëndetësorë dhe në atë mënyrë të definojë nevojën për ndihmë si dhe të planifikojë procesin e përkrahjes dhe terapisë.

Për herë të parë, në kuadër të projektit Erasmus+ „gjuha e përbashkët në shkollë“ ([www.icf-school.eu](http://www.icf-school.eu)) është krijuar „verzioni i KNF-së në gjuhë të kuptueshme për familjen“, e cila ka për qëllim të përkthen pjesërisht gjuhën teknike të KNF-së në një gjuhë të përshtatshme, të kuptueshme për familjen. Me këtë, do t'u mundësohet prindërve, përkëdhelësve si dhe vet fëmijëve ose të rinjve si pjesë e „ekipit përreth familjes“ të bisedojnë me ekspertët në lidhje me problemet shëndetësore, pengesat, qëllimet e pjesëmarrjes si dhe planifikimin e terapisë duke përdorur një gjuhë të përbashkët. Me ndihmën e KNF-së dhe verzionin në gjuhë të kuptueshme për familjen, të gjitha palët e „ekipit përreth familjes“ do mund t'i këmbëjnë mendimet, të përshkruajnë pjesëmarrjen e individit (fëmijë, i ri, ose i rritur) me problem shëndetësor si hap të mëtutjeshëm të bëjnë vlerësimin e pjesëmarrjes dhe të caktojnë qëllime të përbashkëta ndaj atij së bashku me masat për përkrahje dhe terapi. Gjithashtu, pas një kohë të caktuar të planifikuar, mund të bëhet vlerësim mbi atë se a janë arritur qëllimet e caktuara për pjesëmarrje si dhe a kanë dhënë rezultat të mirë masat për përkrahje dhe terapi.

Teksti i futur (çka është KNF-ja) është shkruar në një „gjuhë lehtë të kuptueshme“ me qëllim që t'u mundësohet të gjitha palëve të prekura të kuptojnë çka është KNF-ja dhe pse ajo është e rëndësishme. Përkthimi i kodeve është në listën e kodeve të KNF-së që është bërë nga ekipi ndërkombëtarë dhe ekspertëve të cilët kanë bërë vlerësim shkencor të tekstit. Në këtë mënyrë, për herë të parë u është mundësuar prindërve, gjegjësisht përkëdhelësve, si dhe vetë fëmijëve dhe të rinjve, me ndihmën e verzionit të KNF-së me gjuhë të kuptueshme për familjen (verzion që mund të përdoret çdo ditë edhe nëpër shkollë) të mund të kyçen si anëtarë të barabartë në procesin e përkrahjes dhe terapisë, duke përdorur gjuhë të përbashkët, të këmbëjnë mendimet e tyre me ekspertët si dhe të marrin vendime bashkarisht.



With the support of the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

